

RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2024

NPL Ku'zina sh.a | Prishtinë | Mars 2025

Përmbajtja

Vizioni dhe Misioni	3
Investimet në kapitalin human dhe blerje e aseteve	3
Ngjarjet kryesore të vitit 2024	3
Përmbledhje financiare	4
Për Ne.....	4
Burimet njerëzore.....	5
Komisioni Komunal i Aksionarëve	6
Bordi i drejtorëve.....	7
Komisioni Auditimit	7
Janar-Mars 2024	8
Departamenti i financave	8
Të ardhurat dhe fitimet.....	8
Shpenzimet.....	9
Departamenti i shitjes dhe marketingut.....	10
Departamenti i administratës	11
Departamenti i prodhimit.....	12
Qendrat sociale.....	13
Sektori privat	13
Zyra e prokurimit.....	14
Zyra për marrëdhënie me publikun	14
Departamenti i financave	15
Të ardhurat dhe fitimet.....	15
Shpenzimet.....	16
Departamenti i shitjes dhe marketingut.....	18
Departamenti ligjor dhe i administratës.....	21
Departamenti i prodhimit.....	22
Zyra e prokurimit.....	26
Zyra për Menaxhimin e Kontratave	28
Zyra për marrëdhënie me publikun	32

DEPARTAMENTI I FINANCAVE	33
Të ardhurat dhe fitimet.....	33
Shpenzimet.....	34
DEPARTAMENTI LIGJOR DHE ADMINISTRATËS	36
I. Aktivitetet e realizuara	36
II. Vendime dhe akte të lëshuara.....	36
1. Njoftime dhe shkresa të tjera	36
Departamenti shitje dhe marketing.....	37
Departamenti i shërbimeve të përbashkëta	40
Zyra për Menaxhimin e Kontratave	41
Zyra Prokurimit	44
Departamenti i prodhimit.....	46
Departamenti Ligjor dhe i Administratës	48
II. Aktivitetet e Realizuara	48
II. Vendime dhe Akte të Lëshuara	48
2. Vendime.....	48
3. Opinione ligjore	49
4. Njoftime dhe shkresa të tjera	49
Zyra Prokurimit	49
Departamenti Shitje dhe Marketing.....	51
Departamenti i financave	54
Të ardhurat dhe fitimet.....	54
Shpenzimet.....	55
Departamenti i prodhimit dhe furnizimit.....	57

Vizioni dhe Misioni

Të bëhet sinonim i ushqimit të shëndetshëm, dhe të njihet si shembull i përsosmërisë në ofrimin e produkteve ushqimore për fëmijët, bizneset dhe qytetarët.

Të vazhdojmë angazhimin për ushqim të shëndetshëm, me cilësi, standarde të larta, shije të mirë dhe çmim të volitshëm.

Investimet në kapitalin human dhe blerje e aseteve

Investuam në kapitalin human. Avancimet profesionale në fushën e sigurisë dhe shëndetit në punë, sigurisë së ushqimit, avancime profesionale akademike ndërmarrjes i kanë kushtuar rreth 17,678 euro.

Në këtë drejtim kemi nënshkruar kontratën tre-vjeçare për sigurimin shëndetësor të punëtorëve, e cila në vitin 2024 ka arritur vlerën 20,710 euro. Ndërkohë për të mirën e përgjithshme investuam në instalimin e sistemit solar në hapësirën e ndërmarrjes, projekt ky i realizuar për herë të parë nga një ndërmarrje publike.

Trajnime për avancime profesionale gjatë vitit 2024	17,678€
Sigurimi shëndetësor në 2024	20,710 €
Blerje e aseteve (Mini-Kuzhina për qëndrim tërë ditor)	149,794€

Ngjarjet kryesore të vitit 2024

1. Nënshkrimi i marrëveshjes Brigada e Zjarrfikësve
2. Nënshkrimi i marrëveshjes Shtëpia e të moshuarve
3. Nënshkrimi i marrëveshjes Shkollat fillore (Qëndrimi tërë ditor)
4. Rritja e shërbimit të cateringut
5. Vizita nga fëmijët e Institucionet Parashkollore

Përmbledhje financiare

Vitin 2024 e përmbyllëm me bilanc financiar pozitiv. Në të njëjtën kohë, ndërmarrja është kujdesur që obligimet e saja t'i kryej në afatet e parapara.

Përshkrimi	Vlera në euro
Të hyrat	1,587,087.71€
- Subvencione me TVSh (pajisje)	129,624.00 €
Shpenzimet	636,196.91€
Investimet neto (pajisje)	123,484.76€
Shpenzimet e pagave	733,777.49 €
Mbetje	217,113 €

Pjesëmarrja në të hyra

Përshkrimi	Vlera në %
Pjesëmarrja e të hyrave nga sektori privat në të hyrat totale	3.8%
Shpenzimet e lëndës së parë raporti në të hyra	32%
Raporti i shpenzimeve të pagave në të hyra	46%
Raporti i investimeve dhe shpenzimeve tjera në të hyra	22%

Për Ne

Ku'zina është themeluar me datën 5 Qershor 2019 nga Kuvendi Komunal i Prishtinës. Ku'zina aktualisht furnizon gjithsej 16 çerdhe, prej të cilave 8 janë publike dhe 8 me bazë në komunitet, përveç këtyre aktiviteti i Ku'zines është shtrirë edhe tek Shtëpia e të moshuarve dhe Brigada e Zjarrfikësve. Një aktivitet që po shënon rritje në vazhdimësi është sektori privat, ku në veçanti jemi duke u rritur tek pjesa e kateringut.

Ku'zina është një koncept i kuzhinës që përfshin përgatitjen dhe gatimin e ushqimit në një vend të centralizuar, i cili më pas shpërndahet në vende të ndryshme për konsum. Kjo metodë përdoret

shpesh nga zinxhirët e restoranteve, hotelet, spitalet, dhe institucionet e tjera që kanë nevojë të përgatisin ushqim në sasi të mëdha dhe ta shpërndajnë atë në disa pika shërbimi.

Përparësitë kryesore të një kuzhine qendrore përfshijnë:

1. **Konsistenca në cilësi:** Duke përgatitur të gjitha pjatat në një vend të vetëm, është më e lehtë të sigurohet që cilësia dhe shija e ushqimit të jetë e njëjtë në të gjitha pikat e shërbimit.
2. **Kostot e reduktuara:** Blerjet në sasi të mëdha dhe proceset e standardizuara të përgatitjes ndihmojnë në uljen e kostove.
3. **Efikasiteti operativ:** Ku'zina qendrore mund të përdorë teknologji dhe pajisje të avancuara që mund të jenë të shtrenjta për t'u vendosur në çdo pikë individuale shërbimi.
4. **Kontrolli më i mirë i higjienës:** Meqenëse përgatitja dhe gatimi kryhen në një vend të vetëm, është më e lehtë të kontrollohen standardet e higjienës dhe sigurisë ushqimore.

Në thelb, Ku'zina funksionon si një "fabrikë" ushqimi që shpërndan produkte gjysmë të gatshme ose të gatshme për konsum në vende të ndryshme.

Burimet njerëzore

Ndërmarrja ka trashëguar një staf, ku shumica prej tyre kanë përgatitje të mesme shkollë.

Përveç kësaj stafi është në moshë të shtyrë.

Aktualisht në ndërmarrje janë mbi 90 të punësuar, përfshirë Bordin e Drejtorëve dhe Komisionin Komunal të Aksionareve.

Është bërë vlerësimi i kapaciteteve dhe nevojave të ndërmarrjes për investime në ngritjen e kapaciteteve, jo vetëm në personel por edhe në makineri. Në këtë pikë orientimet tona janë organizimi i trajnimeve për stafit të ndërmarrjes, gjë që edhe ka ndodhe në periudhën raportuese. Moshë mesatare e punëtorëve është 40.3 vjeç.

Evidenca e nivelit të shkollimit të stafit:

Shkolle Filllore 6.06%

Shkolle e Mesme 63.63%

Shkollim i lartë Universitar 30.30%

Raport mbi rekrutimin e stafit për NPL KU'ZINA sh.a .

Sipas Vendimin për themelimin e komisionit përzgjedhës për konkursin e shpallur me dt.17.05.2024 , Komisioni vlerësues ka zhvilluar procedurat e rekrutimit të stafit në bazë të Rregullores për Marrëdhëniet në Punë të ndërmarrjes .

Komisioni i përzgjedhjes për zhvillimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies se punës për konkursin e datës 17 MAJ 2024 pas afatit të dorëzimit të dokumenteve ka pranuar 67 aplikacione për 10 pozitat e hapura nga kandidatet potencial. Pas vlerësimit të aplikacioneve komisioni ka përzgjedh 64 kandidatet të cilët i kanë plotësuar kriteret për pjesëmarrje ne test me shkrim sipas afateve te përcaktuara ne rregullore.

Pas nënshtrimit te testit me shkrim komisioni ka identifikuar se për Pozitën" Teknolog ushqimor" prej tre kandidateve, asnjë nuk e ka kaluar testin me shkrim ose mbi 50 % te pikëve , andaj jemi detyruar qe te veprojmë sipas rregullores .

Komisioni ka zhvilluar procesin e intervistës me gojë me datë 03.07.2024 duke filluar nga ora 09:00 , ku nga 25 kandidat te ftuar, kane marr pjese 24 kandidat. Procesi është zhvilluar konform nenit 14 te rregullores për marrëdhënie ne pune te N.P.L "Kuzhina Qendrore "sh.a.

Gjatë periudhës se intervistës është parashtruar nga një pyetje profesionale nga te gjithë anëtarët e komisionit për 9 pozitat e hapura te konkursit për plotësimin e vendeve te punës ne N.P.L "KU'ZINA "sh.a.. Te pranishëm ne intervistë ishin gjithsej 24 kandidat nga 25 te përzgjedhur për intervistë me gojë.

Pas intervistës për secilin kandidat te pranishëm është plotësuar formulari " Vlerësimi individual i kandidateve për vendin e punë" nga secili anëtar i komisionit dhe ne fund janë mbledh pikët totale të testit me shkrim dhe gojë mbi bazën e pikëve te përcaktuara ne vlerësim. Pikët totale te fituara te secilit kandidat te intervistuar me goje dhe me shkrim si dhe kandidatet me te suksesshëm janë paraqit ne listën e Komisionit përzgjedhës: (shih listën e publikuar ne ueb faqe.).

Komisioni Komunal i Aksionarëve

Komunal i Aksionarëve i përgjigjet Kuvendit Komunal mbi mënyrën e ushtrimit të kompetencave dhe përgjegjësi të cilat u janë dhënë me ligj. Komisioni Komunal i Aksionarëve gjatë 2024, i ka raportuar Kuvendit Komunal mbi performancën kompetencave dhe përgjegjësi, si dhe mbi arritjen e objektivave të përcaktuara sipas

ligjit. Gjatë 2024, Komisioni Komunal i Aksionarëve i ka siguruar të dhëna kuantitative dhe të qëndrueshme publikut dhe Kuvendit Komunal mbi mënyrën e menaxhimit të NPL Ku'zina

Bordi i drejtorëve

Bordi i drejtove gjatë periudhës raportuese ka qenë i angazhuar në hartimin dhe miratimin e politikave të atilla që qojnë në zhvillimin e ndërmarrjes. Bordi gjatë periudhës raportuese ka mbajtur mbledhje të rregullta ku janë trajtuar disa pika të rendit të ditës. Nder temat që janë trajtuar; është miratuar Rregullorja e Brendshme si dhe plotësim ndryshimi i rregullores për paga dhe kompensime të tjera.

Bordi në mënyrë periodike ka përcjell zhvillimet brenda ndërmarrjes si dhe në koordinimin me menaxhmentin ka ndërmarr veprime që kanë pasur ndikim pozitiv në performances financiare të ndërmarrjes.

Në një proces të hapur dhe konkurrues, Bordi brenda përgjegjësive ligjore ka zhvilluar procesin e rekrutimit për pozitën e Kryeshefit të ndërmarrjes, çka ka rezultuar që brenda afatit të paraparë ligjor ky proces të përmbyllet dhe si i tillë edhe të formalizohet.

Bordi ka asistuar menaxhmentin edhe në komunikime me palët e treta, veçmas me Komunën e Prishtinës, ku si rezultat kemi arritur që të përfshihemi në planet e tyre zhvillimore.

Komisioni Auditimit

Komisioni Komunal i Aksionarëve gjatë vitit 2024 ka mbajtur mbledhje të rregullta. Komisioni i Auditimit gjatë vitit 2024 ka përgatitur dhe ka zbuluar në mënyrë publike deklaratën për politikën e kompensimit për drejtorët dhe zyrtarët e NP-së. Brenda përgjegjësive të tij ligjore, Komisioni i Auditimit ka shqyrtuar dhe aprovuar dokumente të rëndësishme që kanë ndikuar në perspektiven financiare të ndërmarrjes

Tremujori i parë

Janar-Mars 2024

Departamenti i financave

Departamenti i financave në periudhën raportuese ka luajtur një rol të shumëfishtë në përfshin menaxhimin e aseteve financiare të ndërmarrjes, planifikimin financiar, dhe sigurimin e qëndrueshmërisë ekonomike. Roli i këtij departamenti mund të përmbledhet në funksionet e mëposhtme kryesore siç është planifikimi financiar dhe buxheti, kontabiliteti dhe raportimi financiar si dhe kontrolli i kostove dhe efikasiteti operativ. Gjatë periudhës raportuese, departamenti ka luajtur një rol të rëndësishëm në sigurimin e qëndrueshmërisë financiare dhe rritjes së ndërmarrjes.

Të ardhurat dhe fitimet

Periudha e parë e vitit 2024 ka arritur vlerën 301,482.85 euro. Rritja e të hyrave ka ndodhur në muajin Mars të këtij viti si rezultat i nënshkrimit të aneks kontratës me Komunën e Prishtinës për furnizim me shujta Brigadën e Zjarrfikësve dhe Shtëpinë e të Moshuarve në Prishtinë.

Në këtë periudhë të vitit 2023, të hyrat kanë qenë 262,071.20 euro.

Në TM1 të vitit 2024 kemi 42,411.65 euro me shume të hyra. Kjo me se shumti është vërejtur tek të hyrat nga IP dhe QS, sepse nga operatorët privat kemi një rënie të lehtë prej 494.04 euro krahasuar me vitin paraprak.

Ky trend i lehtë rënës ka ndodhur në muajin Mars dhe këtu besohet se ka ndikuar muaji i Ramazanit.

Shitje TM1	IP dhe QS	Op.Privat	Totali
Janar	83,769.49	3,507.79	87,277.28
Shkurt	94,920.34	4,969.92	99,890.26
Mars	109,973.11	4,342.2	114,315.31
	288,662.94	12,819.91	301,482.85

Në tre mujorin e parë të vitit 2024, Ndërmarrja ka ndarë buxhet prej 134,686.07 euro për paga.

Krahasuar me vitin e kaluar për periudhën e njëjte kemi shtim të buxhetit prej 10,646.88 euro. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i shtimit të numrit të

punëtoreve dhe daljes në pension të punëtorëve, ku sipas Rregullores për paga dhe kompensime, ju takojnë tri paga shtese. Arsye tjetër për shtimin e buxhetit të pagave është ndryshimi i vëllimit të punës, ku me rastin e furnizimit të Shtëpisë së të Moshuarve dhe Brigadën e Zjarrfikësve, puna në Kuzhine, është bërë 24/7, që reflekton në mëditjet e ditëve të fundjavave dhe festave.

Viti 2024	Paga Bruto
Muaji Janar	47,645.37
Muaji Shkurt	42,305.00
Muaji Mars	44,735.7
Totali për tre muaj	134,686.07

Shpenzimet

Në tabelën me poshtë janë paraqitur llojet e shpenzimeve të ndodhura gjatë këtij tre muajori të parë. Shpenzimet për lenden e parë janë rritur në muajin Mars, kjo si rezultat i rritjes së numrit të shujtave të prodhuara. Gjithashtu shpenzimet e naftës janë rritur për shkak të transportit që duhet të bëhet tre here në ditë për Shtëpinë e të Moshuarave. Zëri tjetër që merr pjesë me shumë në tabelën e shpenzimeve, është ai shpenzimeve për energji elektrike.

Krahasuar me vitin e kaluar, blerjet e lendes së parë janë shtuar për 13,852.57 euro. Në këtë periudhë të vitit nuk kemi pasur blerje investive apo shpenzime kapitale.

Tabela e shpenzimeve

	Janar	Shkurt	Mars	Totali
Totali i shpenzimeve	38,104.54	38,560.87	44,722.16	121,387.57
Lënda e parë	30,418.87	30,823.06	36,708.60	97,950.53
Shpenzime për naftë	514.41	523.76	855.55	1,893.72
Shpenzime për telefon	25.1	193.00	90.19	308.29
Shpenzime të reprezentacionit	88.05	264.52	55.08	407.65
Shpenzime të interneti	50.85	50.85	50.85	152.55

Shpenzimet e ujit		2.00	2	4.00
Shpenzime të rrymës	1,192.49	1,209.71	1,263.72	3,665.92
Shpenzime për material shpenzues	14.83	104.67	27.46	146.96
Shpenzimet për zyre	105.34	183.57	138.88	427.77
ARBK		20.00		20
Shpenzimet e reklamës + Revista	266.09	83.89	117.79	467.77
Shpenzimet e higjienës		402.97		402.97
Shpenzimet e mirëmbajtjes se ueb faqes	133.39			133.39
Shpenzimet e mirëmbajtjes se veturave+ sigurimi	122	847.28		969.28
Shpenzimet e mirëmbajtjes se pajisjeve te kuzhinës	2400			2,400.00
Shpenzimet e paketimeve	137.5	1,975.09	428.56	2,541.15
Shpenzimet për GPS te veturave		67.80		67.80
Shpenzime për mirëmbajtje te ambientit- NPL Gjellbra			3,199.58	3,199.58
Shpenzime për analiza- IKSHPK	802.12			802.12
Shpenzimet e sigurimit shëndetësor	1833.5	1,808.70	1,783.90	5426.1

Departamenti i shitjes dhe marketingut

Gjatë kësaj periudhe të raportimit, departamenti i ka kryer të gjithë detyrat dhe përgjegjësit për të cilat është i thirrur.

Është bërë përgatitja e rregullt mujore e specifikacioneve të shujtave të cilat dërgohen në baza të përditshme në Institucionet Parashkollore (IP) dhe në Qendrat Sociale (Aktash dhe Tophane).

Është bërë përgatitja mujore e specifikacionit dhe konstatimit për përgatitjen e faturës

që i dërgohet Komunës, sipas Kontratës në shtëpi, të nënshkruar me Komunën e Prishtinës.

Shpërndarja e shujtave për tre mujorin e parë është paraqitur në tabelën me poshtë.

Numri i fëmijëve në Institucione Parashkollore Publike ka shënuar rritje për tre mujorin e parë të vitit 2024.

Rritje pozitive ndërmarrja ka shënuar edhe në sektorin privat, ku nga tre (3) biznese që i

kemi pasur të kontraktuara në fillim të vitit, kemi arritur deri në katër (4) biznese në periudhën e parë të vitit. Kurse, në këtë periudhë duke përfshirë edhe bizneset të cilat kanë marrë shërbime (por nuk janë të kontraktuara) dhe bizneset që kanë marrë shërbimet e cateringut, kemi arritur deri në 21 biznese të shërbyera nga Ku`zina.

Po ashtu, departamenti ynë ka vazhduar të bëjë edhe shpërndarjen e shujtave shtesë, pjesë e projektit të fituar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë. Shpërndarja është finalizuar më 29.02.2024, ku në dy qendrat sociale (Aktash dhe Tophane) janë shpërndarë nga 75 shujta, në total 150 shujta ditore.

Vlen të theksohet që në këtë periudhë të raportimit, më saktësisht nga fillimi i muajit Mars, departamenti ynë ka bërë edhe shpërndarjen e shujtave për Qendrën Sociale të të moshuarve dhe për BPZ Prishtinë (zjarrfikësit). Shpërndarja e këtyre shujtave për tre mujorin e parë është paraqitur në tabelën me poshtë.

Nr. i fëmijëve	Janar	Shkurt	Mars
Institucionet Parashkollore Publike	23459	28514	28984
Institucionet Parashkollore me bazë në komunitet	17485	17500	18375
Qendrat Sociale	6000	6000	6300
Qendrat Sociale (projekti nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë)	3000	3000	n/a
Qendra Sociale për të moshuar	n/a	n/a	6541
BPZ Prishtinë (zjarrfikësit)	n/a	n/a	1749
Porosit private	3-biznese, 1699 porosi	3-biznese, 1920 porosi	4-biznese, 1321 porosi

Departamenti i administratës

Departamenti i Administratës në periudhën e 3 mujorit të parë për vitin 2024 ka kryer këto aktivitete:

Në bashkëpunim edhe me Departamentin e Financave ka përcjelle procesin e regjistrimit të shujtave si dhe dërgimin e faturës së rregullt mujore në Komunën e Prishtinës. Duhet të theksojmë që gjatë kësaj periudhe kohore,

ne kemi kryer specifikat edhe për aneks kontratën e re që përfshinë dërgimin e shujtave në Qendrën e të Moshuarve dhe tek Brigada e Zjarrfikëseve.

Gjatë kësaj periudhe kohore Departamenti i Administratës është angazhuar që përmes institucionit të Komunës së Prishtinës respektivisht Drejtorisë së Katastrit/Pronës të siguroi planin e detajizuar të objektit të ndërmarrjes tonë me lokacion në "Ulpianë". Ky dokument është siguruar dhe është i nevojshëm për ndryshime që do t'i bëjmë në të ardhmen brenda objektit tonë.

Në tre mujorin e parë, kemi bërë kërkesë pranë ARBK-së për ndryshimet në Certifikatën e Biznesit të ndërmarrjes. Në këtë kërkesë kemi përfshirë ndryshimin e emrit ku nga N.P.L "Kuzhina Qendrore" sh.a. është bërë N.P.L "Ku'zina" sh.a. Kemi bërë po ashtu ndryshimin e të dhënave mbi funksionet e Aksionareve, Bordin Drejtues si dhe Kryeshefit Ekzekutiv.

Sipas projektit të zhvilluar dhe të dorëzuar në vitin 2022 pranë Ministrisë së Financave dhe Transfereve, në këtë tre mujor, sektori i Menaxhimit dhe Zhvillimit të Projekteve ka përfunduar edhe raportin e fundit që duhej të dorëzohej në Ministrinë e Financave dhe Transfereve.

Gjatë kësaj periudhe, zyra e IT-së ka ndihmuar zyrën e mediave për mirëmbajtjen e rrjeteve sociale Instagram dhe Facebook, ka ndihmuar departamentin në përpilimin e planit vjetor sa i takon punës brenda departamentit, si dhe në përputhje me kërkesat e ndërmarrjes ka kryer edhe punë të tjera të cilat i janë deleguar.

Kemi rregulluar hapësirat gjelbëruese. Vlen të theksohet se ndihmë të konsiderueshme ka kryer edhe bashkëpunimi që N.P.L "Ku'zina" sh.a. ka me ndërmarrjen "Gjelbër" sh.a. të cilët kanë ndihmuar në mirëmbajtjen e hapësirës publike.

Departamenti i prodhimit

Departamenti i Prodhimit, përfshin në vete pjesën e përgatitjes së ushqimit. Gjatë kësaj periudhe kohore janë bërë zhvillime pozitive në këtë departament, në të gjitha sektorët janë bërë kontrata te reja si kontrata nga "BRIGADA E ZJARFIKSAVE" dhe "SHTËPIA E TË MOSHUARVE" në këto kontrata janë bërë menyja të veçanta për secilën kontratë, mënuat janë të pasura me lloje të ndryshme të ushqimeve si dhe me vlera të larta ushqyese, të cilat janë bërë nga nutricionistët.

Departamenti i prodhimit është i ndarë në tre sektorë: Institucionet Parashkollore, Qendrat Sociale (Aktash, Tophane) si dhe sektori privat. Gjatë periudhës raportuese në sektorin e Institucioneve Parashkollore është bërë

kontrata e re për marrjen e strishave në të gjitha kopshtet me Institutin e Shëndetit Publik të Kosovës për sigurinë dhe kujdesin e fëmijëve ,si dhe vetëdijesimin e personelit për kushte sa më të mira higjienikë.

Nga këto mostra departamenti mundë të ketë:

- Analiza mikrobiologjike
- Analiza fizike-kimike .

Këto analiza kryhen në institutin kombëtar të shëndetësisë publike.

Në periudhën në fjalë për këtë pjesë të departamentit të prodhimit janë përgatitur dhe shërbyer 134, mijë 317 shujta të ngrohta për fëmijët e vendosur në institucionet parashkollore publike dhe ato më bazë në komunitet.

Qendrat sociale

Në departamenti e prodhimit është po ashtu sektori i qendrës sociale ku në këtë sektor përgatitet ushqimi për dy qendra: Qendra në Aktash si dhe Qendra në Tophane. Këtu bëhet fjalë për përgatitjen e ushqimit për familjet me gjendje të rënd ekonomike, janë përgatitur dhe shërbyer 18mijë e 300shujta

Qendrat Sociale (projekti nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë) ka pasur 6000mijë shujta të cilat bëhen në mënyrën sa më të mirë të mundshme për këtë sektor

Qendra Sociale për të moshuar në këtë periudhë tre mujore janë përgatitur 6541 shujta dhe është bërë menzja e veçantë për të moshuarit .

BPZ Prishtinë (zjarrfikësit) në këtë periudhë tre mujore janë përgatitur 1749 shujta, po ashtu edhe tek BPZ është bërë menzja e veçantë,

Spektori privat

Spektori privatë gjatë kësaj periudhe ka pasur një zhvillim të shkëlqyer në cilësinë si dhe janë bërë kontrata të reja në këtë periudhë tre mujore janë bërë 6 kontrata të reja.

Në këtë periudhë janë përgatitur 4,940 shujta. Spektori privat ka zhvilluar po ashtu "finger food" ku kemi pasur organizime te ndryshme kokteje rasti. Gjatë kësaj periudhe kohore tre mujore ka arritur të zgjeroj bashkëpunimin për evente me të mëdha edhe me individ privat. Shpërndarja e shujtave për tre mujorin është paraqitur në tabelën me poshtë. Numri i fëmijëve në Institucione Parashkollore Publike ka shënuar rritje për tre mujorin e parë të vitit 2024

Zyra e prokurimit

Në tremujorin e parë të vitit 2024, Zyra e Prokurimit ka zhvilluar një sërë aktivitete të rëndësishme për të filluar organizimin e vitit dhe për të ndjekur obligimet e saj. Disa nga aktivitetet kryesore të zhvilluara përfshijnë.

Dorëzimi i Planit të Prokurimit:

Zyra e Prokurimit ka dorëzuar planin e prokurimit në Agjencinë Qendrore të Prokurimit (AQP). Ky plan përfshin aktivitetet e planifikuara nga Kuzhina për vitin 2024, përfshirë emrin e projektit, vlerën dhe detajet e tjera specifike.

Raporti i Kontratave të Nënshkuara:

Është dorëzuar raporti i kontratave të nënshkuara në Komisionin Rregullativ për Prokurim Publik (KRPP). Ky raport përfshin të gjitha kontratat e nënshkuara nga Kuzhina Qendrore gjatë vitit 2023, me një total prej 25 kontratash në vlerë 332,841.60 euro.

Raporti detajon vlerën e kontratave, llojin e procedurës së përdorur, dhe informacione të tjera relevante, duke përfshirë edhe kontratat në minimale.

Në këtë raport nuk përfshihen kontratat që janë me AQP.

Parashikimet për Vitin 2024:

Janë dërguar parashikimet për kontratat që planifikohen të vazhdojnë me AQP gjatë vitit 2024.

Procedura e Mini-Tenderit për Pemë dhe Perime:

Gjatë këtij tremujori, Kuzhina ka zhvilluar procedurën e mini-tenderit për peme dhe perime, në këtë procedurë janë pranuar 3 oferta, dhe oferta e përgjegjshme me çmimin 80,908.98 euro ka fituar, duke qenë më e lira dhe e përgjegjshme. Kjo kontratë është në fazën e implementimit për 6 muaj, duke filluar nga marsi.

Po ashtu, gjatë kësaj periudhë janë dërguar edhe planifikimet për kontratat e ardhshme lidhur me këtë procedurë në AQP.

Zyra për marrëdhënie me publikun

Ndërmarrja gjatë këtij tremujori ka shënuar përparim të konsiderueshëm në rritjen e bashkëpunimit me media dhe paraqitjen në rrjete sociale për të pasqyruar punën e stafit që bëhet për fuqizimin e ndërmarrjes dhe të shërbimit.

Praktike e vazhdueshme e ndërmarrjes është marrja e inputeve nga klientela dhe përmirësimi i shërbimeve në vazhdimësi.

Gjatë këtij tre mujori ndërmarrja ka publikuar revistën tashmë mujore Kuz'ina në tre vëllime. Në revista përfshihen aktivitete e muajit në ndërmarrje, informacione të ndryshme rreth shëndetit, këshilla, si dhe intervistat me staf.

Tremujori i dytë

Prill-Qershor 2024

Departamenti i financave

Departamenti i financave në periudhën raportuese ka luajtur një rol të shumëfishtë në përfshin menaxhimin e aseteve financiare të ndërmarrjes, planifikimin financiar, dhe sigurimin e qëndrueshmërisë ekonomike. Roli i këtij departamenti mund të përmblihet në funksionet e mëposhtme kryesore siç është planifikimi financiar dhe buxhetimi, kontabiliteti dhe raportimi financiar si dhe kontrolli i kostove dhe efikasiteti operativ. Gjatë periudhës raportuese, departamenti ka luajtur një rol të rëndësishëm në sigurimin e qëndrueshmërisë financiare dhe rritjes së ndërmarrjes.

Të ardhurat dhe fitimet

Periudha e dytë e vitit 2024 ka arritur vlerën e shitjes në 319,581.01 euro. Rritja e të hyrave ka ndodhur më së shumti në muajin Maj të këtij viti si rezultat i rritjes së numrit të vijueshmërisë së fëmijëve pranë Institucioneve Parashkollore Publike dhe Publiko-private.

Në këtë periudhë të vitit të kaluar (2023), të hyrat kanë qenë 265,386.11 euro.

Në TM2 të vitit 2024 kemi 54,194.09 euro më shumë të hyra krahasuar me vitin 2023. Kjo me së shumti është vërejtur tek të hyrat nga IP dhe QS, gjithashtu nga konsumi i Shtëpisë së të moshuarave dhe Brigadës së Zjarrfikësve. Kurse të hyrat nga operatorët privat janë zvogëluar për 2,366.07 euro krahasuar me vitin paraprak. Totali i këtyre të hyrave është 14,005.06 euro. Nga 18 Qershori kemi zbatuar çmimoren dhe menynë e re në sektorin privat. Stina e verës që lidhet me pushimet, pezullimi i punës së klientëve tanë që merren me ndërtimtari për shkak të temperaturave të larta

dhe çmimet e reja mund të jenë faktor signifikant në rënien e kërkesës për produktet e Kuzhinës.

Shitje TM2	IP, QS, SHP,BZ	Op.Privat	Totali
Prill	103,228.76	4,870.43	108,099.19
Maj	108,013.53	4,509.38	112,522.91
Qershor	94,333.67	4,625.25	98,958.91
	305,575.96	14,005.06	319,581.01

Në tre mujorin e dytë të vitit 2024, Ndërmarrja ka ndarë buxhet prej 157,622.35 euro për paga.

Krahasuar me vitin e kaluar për periudhën e njëjte kemi shtim të buxhetit prej 32,809.35 euro. Për shkak të performancës së mirë financiare është rekomanduar të kemi një rritje në paga si formë shpërblimi dhe motivimi për punëtorët. Në muajin Prill, është rritur paga minimale nga 400 euro në 470 euro, gjithashtu me miratim të Bordit të Drejtoreve kemi pasur rritje në vlerë monetare për 70 euro për secilën pozitë. Ky ndryshim në buxhetin e pagave rrjedh edhe si rezultat i vëllimit të punës, ku me rastin e furnizimit të Shtëpisë së të Moshuarve dhe Brigadën e Zjarrfikësve, puna në Kuzhinë, është bërë 24/7, që reflekton në mëditjet e ditëve të fundjavave dhe festave.

Viti 2024	Paga Bruto
Muaji Prill	51,436.57
Muaji Maj	53,856.88
Muaji Qershor	52,328.90
Totali për tre muaj	157,622.35

Shpenzimet

Në tabelën me poshtë janë paraqitur llojet e shpenzimeve të ndodhura gjatë këtij tre mujori të dytë. Në këtë periudhë zëri i cili ka shënuar vlerën më të madhe është ai i shpenzimeve për trajnime. Trajnime këto të llojit: Haccap dhe siguria e ushqimit në institucionet ku shpërndahet.

Në vitin 2023 vlera totale e shpenzimeve për këtë periudhë ka qenë 147,953 euro, sepse në të njëjtën periudhë kemi pasur investime dhe blerje të aseteve. Kurse në vitin 2024 ndërmarrja ka realizuar vetëm shpenzime

operative. Gjithashtu shohim që vlera e shitur është në proporcion te drejte me vlerën e blerjes së lendes së pare.

Tabela e shpenzimeve

	Prill	Maj	Qershor	Totali
Totali i shpenzimeve	43,416.51	51,816.52	35,881.98	131,114.47
Lënda e parë	36,298.42	34,601.64	29,222.52	100,122.58
Shpenzime për naftë	511.85	629.40	585.89	1,770.65
Shpenzime për telefon	23.20	72.03	103.34	198.57
Shpenzime për auditim	950.00			950
Shpenzime për trajnime-avancim	400.00	10,295.00		10,695.00
Shpenzime të reprezentacionit	71.36	78.39	186.56	336.31
Shpenzime të interneti	50.85	50.85	50.85	152.55
Shpenzime të rrymës	1,169.10	1,446.42	1,410.35	2,615.52
Shpenzime për material shpenzues	125.75	36.06	26.13	187.94
Shpenzimet për zyre	105.09	419.98	12.71	537.78
Shpenzimet e reklamës dhe Revista	83.89		83.89	167.78
Shpenzimet e higjienës		431.10		431.10
Shpenzimet e dezinfektimit		161.02		161.02
Shpenzimet e mirëmbajtjes			222.53	222.53
Shpenzimet e mirëmbajtjes se ueb faqes	200.08			200.08
Shpenzimet e mirëmbajtjes se veturave, sigurimi	185.22	76.00	1,077.97	1,339.19
Shpenzimet e mirëmbajtjes se liftave		45.00	322	367.00
Shpenzimet e mirëmbajtjes se programit kontabilitetit	200.00			200.00
Shpenzimet e paketimeve		262.03	613.47	875.50
Shpenzimet për GPS te veturave	67.80			67.80
Shpenzime tjera			273.23	273.23
Shpenzime për mirëmbajtës se ambientit-NPL Gjellbër		1,232.80		1,232.80
Shpenzime për analiza laboratorike- IKSHPK	1,190.00	264.00		1,454.00

Shpenzimet e sigurimit shëndetësor	1,783.90	1,714.80	1,690	5,188.70
------------------------------------	----------	----------	-------	----------



Departamenti i shitjes dhe marketingut

Gjatë kësaj periudhe të raportimit, departamenti i ka kryer të gjithë detyrat dhe përgjegjësit për të cilat është i thirrur. Është bërë përgatitja e rregullt mujore e specifikacioneve të shujtave të cilat dërgohen në baza të përditshme në Institucionet Parashkollore (IP), Qendrat Sociale (Aktash dhe Tophane), BPZ Zjarrfikësit dhe Qendrën Sociale për të moshuar. Është bërë përgatitja mujore e specifikacionit dhe konstatimit për përgatitjen e faturës që i dërgohet Komunës, sipas Kontratës në shtëpi, të nënshkruar me Komunën e Prishtinës. Më poshtë, mund të gjeni edhe tabelat e shpërndarjes së shujtave për tre mujorin e dytë të vitit 2024.

	Prill	Maj	Qershor
Institucionet Parashkollore Publike	25257	28323	23574
Institucionet Parashkollore me bazë në komunitet	16585	17545	16500
Qendrat Sociale	5700	6000	5700
Qendra Sociale për të moshuar	6047	6062	5571
BPZ Prishtinë (zjarrfikësit)	1751	1920	1668
Shërbimet Catering	7 organizime 235 persona	9 organizime 490 persona	8 organizime 202 persona
Porosit private	5-biznese, 1742 porosi	8-biznese, 2251 porosi	7-biznese, 1705 porosi


Në tremujorin e fundit të vitit 2024, Kuzhina Qendrore ka bërë disa ndryshime të vogla në sektorin e shitjeve private. Duke filluar nga Qershori i këtij viti, ndërmarrja ka filluar të operoj me çmime dhe meny të re. Kurse, tek pjesa e shpërndarjes së produkteve ushqimore për Institucionet Publike, Qendrat Sociale Aktash dhe Tophane, Qendra Sociale për të

moshuar dhe BPZ Zjarrfikësit, nuk kemi pasur asnjë ndryshim (krahasuar me periudhën e parë të vitit).




Gjatë periudhës së raportimit, ndërmarrja ka shënuar rritje pozitive (krahasuar me periudhën e tre mujorit të parë të vitit 2024) tek sektori privat. Me mbylljen e tre mujorit të dytë, ndërmarrja ka shpërndarë 1,232 më shumë porosi private se në periudhën e TM1. Krahasuar me këtë periudhë, kemi shënuar rritje edhe me shërbimet Catering, ku si përfundim i

këtij tre mujori kemi arritur të shpërndajmë ushqim për 24 organizime të ndryshme, përfshirë 927 persona. Si përfundim, nga tre (3) biznese të kontraktuara që kemi pasur në fillim të vitit, kemi arritur në shtatë (7) biznese me kontratë dhe dhjetëra të tjera, të cilat nuk janë të kontraktuara por porosisin shujta ushqimore në baza ditore.



Krahasuar me periudhën e njëjtë (TM2) të vitit të kaluar, ndërmarrja ka shënuar rënie si tek numri i fëmijëve tek Institucionet Parashkollore por edhe tek shitjet private. Rritje të lehtë ndërmarrja ka pasur tek shërbimet Catering, ku në periudhën e njëjte vitin e kaluar janë organizuar 8 koktej rasti, për 305 persona, kurse në vitin 2024 janë organizuar 24 koktej rasti për 927 persona. Për periudhën e njëjtë kohore, numri i shujtave të shpërndara tek Qendrat Sociale Aktash dhe Tophane ka mbetur i njëjtë, ku për dy vitet në tre mujorshin e dytë janë shpërndarë nga 17,400 shujta.

Vlen të theksohet se në tre mujorin e dytë të vitit të kaluar, nuk kemi pasur të kontraktuar Qendrën Sociale për të moshuar dhe BPZ Zjarrfikësit, kontratë kjo e cila ka bërë diferencën në numrin e shujtave të shpërndara.



Departamenti ligjor dhe i administratës

Në këtë raport do të paraqitet një përmbledhje e punës së Departamentit Ligjor dhe Administratës të Ndërmarrjes, punë e cila ka qenë në përputhje me kërkesat dhe nevojat e shfaqura gjatë tremujorit të dytë të vitit 2024 por edhe si nevojë për përmirësim të akteve ligjore dhe nënligjore me qëllim për të arritur një zbatim me të drejtë normave ligjore. Me poshtë po paraqesim punët e realizuara.

Punët e realizuara

Pas njohjes së nevojave të ndërmarrjes si Departamenti Ligjor dhe Administrate po i prezantojmë më poshtë punët të cilat janë kryer:

Hartimi i plotësim ndryshimit të Rregullores për paga dhe kompensime të tjera.

Përgatitja dhe shpallja e konkursit publik për plotësimin e vendeve të punës të dt. 17 Maj 2024.

Vendimi për sistematizimin e vendeve të punës në përputhje me rregulloren e re për sistematizim të punëve dhe detyrave të punës.

Ka përpiluar kërkesën për iniciimin e procedurës tenderuese për marrje me qira të 6 veturave për Ndërmarrjen.

Ka menaxhuar kontratën dhe ka kryer të gjitha obligimet si Menaxher i kontratës së sigurimit shëndetësor për punonjësit e Ndërmarrjes.

Si person përgjegjës apo person kontaktues nga Ndërmarrja për Agjencinë Kundër Korrupsion ka kryer edhe ndryshimet e nevojshme në sistemin për deklarimin e pasurisë.

Hartimi i kontratave për ofrimin e shujtave ushqimore.

Krijimi i sistemit të ri të mbajtjes së evidencës së pushimeve të punonjësve

Punë të tjera të deleguara nga Kryeshefi Ekzekutiv, që kanë të bëjnë kryesisht me përmirësimin e infrastrukturës së objektit të Ndërmarrjes.

Gjithashtu gjatë kësaj periudhe Departamenti Ligjor dhe Administratë është marrë edhe me trajtimin e kërkesave nga ana e punëtoreve, dhe ka nxjerrë akte si p.sh. vendime, urdhëresa, njoftime dhe shkresa të tjera, të cilat për qëllim kanë pasur mbarëvajtjen dhe organizmin sa më të mirë të punës në Ndërmarrje.

Departamenti Ligjor dhe Administratë është krijuar pas miratimit të Rregullores për sistematizim të vendeve të punës dhe detyrave të punës me 26 Shkurt 2024, si dhe funksionalizimi i plotë i këtij Departamenti ka filluar me dt. 01.05.2024, prandaj edhe nuk kam mundur të nxjerr një masë krahasuese.

Departamenti i prodhimit

Departamenti i Prodhimit, përfshin në vetë pjesën e përgatitjes së ushqimit. Gjatë kësaj periudhe kohore janë bërë zhvillime pozitive në këtë departament, në të gjitha sektorët janë bërë kontrata të reja si kontrata nga "BRIGADA E ZJARFIKSAVE" dhe "SHTËPIA E TË MOSHUARVE" në këto kontrata janë bërë menytat të veçanta për secilën kontratë, menytat janë të pasura me lloje të ndryshme të ushqimeve si dhe me vlera të larta ushqyese, të cilat janë bërë nga nutricionistët.

Departamenti i prodhimit është i ndarë në tre sektorë: Institucionet Parashkollore, Qendrat Sociale (Aktash, Tophane) si dhe sektori privat. Gjatë periudhës raportuese në sektorin e Institucioneve Parashkollore është bërë kontrata e re për marrjen e strishave në të gjitha kopshtet me Institutin e Shëndetit Publik të Kosovës për sigurinë dhe kujdesin e fëmijëve, si dhe vetëdijësimin e personelit për kushte sa më të mira higjienike.

Departamenti i Prodhimit, përfshinë në vetë pjesën e përgatitjes së ushqimit. Gjatë periudhës raportuese të TM2 2023 kanë qenë, "Institucionet Parashkollore", "Qendrat Sociale" si dhe "Sektori Privat", ndërsa në TM2 2024 janë shtuar dy qendra të tjera si Qendra e të moshuarve si dhe Brigada e Zjarrrfikësive. Kjo ka pasur efekte pozitive në departament të prodhimit.

Për të dy këto qendra janë bërë menÿja të veçanta me vlera të larta ushqyese. Po ashtu tek Qendra e të moshuarve, ushqimi përgatitet edhe për një pjesë të caktuar të moshuarve me diabet. Këtu ndërmarrja ka pasur aktivitete të ndryshme përveç ushqimeve që kanë pasur në meny.

Gjatë kësaj periudhe janë mbajtur 24 evente. Po ashtu tek sektori privat janë disa ushqime që janë më të preferuarat e klientëve tanë që janë krijuar nga vet në recetat si: makarona kuzhine, qofte kuzhine, hamburger kuzhine, patate në furrë etj.

Institucionet dhe Qendrat, ku KU'ZINA ofron shujtat:




Përgatitja e shujtave në TM2 2023 dhe TM2 2024

	TM2 Prill 2023	TM2 Prill 2024	TM2 Maj 2023	TM2 Maj 2024	TM2 Qershor 2023	TM2 Qershor 2024
Institucionet Parashkollore Publike	21,203	25,257	30,397	28,323	27,376	23,574
Institucionet Parashkollore me bazë në komunitet	13,920	16,585	18,434	17,545	18,854,	16,500
Qendrat Sociale	4,800	5,700	6,300	6,000	6,300	5,700
Shtëpia e të moshuarve	/	6,047	/	6,064	/	5,571
BPZ Prishtinë (zjarrfikësit)	/	1,751	/	1,920	/	1,668

Porosi privat	9-biznese 1440 porosi	5- biznese, 1742 porosi	7- biznese 2636	8- biznese, 2251 porosi	12 biznese 3126 porosi	7- biznese, 1705 porosi
Catering		7evente 235 persona		9evente 490 persona		Qershor 8evente 202 porosi
Totali shujtave për muaj	41,363	57,317	57,767	62,593	55,656	54,920

Shpërndarja e përgjithshme e shujtave në TM2 2023 DHE TM2 2024 nga KU'ZINA



Kontrollet laboratorike

Tek TM2 2023 është bërë IKSHPK për kontrollin rutinë të ambientit dhe ushqimit. Mostrat të cilat merren analizohen dhe komentohen rezultatet me rekomandimet e dhëna nga instituti të cilat me pas zbatohen nga Kuzhina Qendrore. Për sigurinë, kujdesin e përgatitjes së ushqimeve janë marrë mostrat nga çdo lloje i përgatitjes së ushqimit. Nga këto mostra departamenti mundë të ketë

- Analiza mikrobiologjike
- Analiza fizike-kimike

Këto analiza kryhen në institutin kombëtar të shëndetësisë publike si dhe në laboratorët të cilët janë të certifikuar.

Në periudhën TM2 2024 përveç kontratës së re që kemi bërë me IKSHPK dhe kontrolles rutinë që kemi bërë në objekt të kuzhinës ,kemi dal në disa kopshte të kryeqyteti për marrjen e strishave sanitare. Gjithashtu këto analiza janë bere edhe ne objektin e Shtëpisë së të moshuarve dhe Brigadën e Zjarrfikësve. Gjatë inspektimit kemi analizuar edhe shërbimin e ushqimit. Rezultatet nga këto vizita dhe analizave bakteriologjike dhe kimike, janë që

nuk ka të gjeturat për elemente bakteriologjike brenda mostrave të marra për testim.

Zyra e prokurimit

Në tremujorin e dytë të vitit 2024, Zyra e Prokurimit ka zhvilluar një sërë aktivitete të rëndësishme për të filluar organizimin e vitit dhe për të ndjekur obligimet e saj. Disa nga aktivitetet kryesore të zhvilluara përfshijnë.

Tabela 1. Aktivitetet e prokurimit

Nr.	Aktiviteti i Prokurimit	Vlera e parashikuar (€)	Procesi
1.	Auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2023	950	Anuluar
2.	Auditimi i pasqyrave financiare për vitin 2023- ri tender	950	Kontraktuar
3.	Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave të Kuzhinës	5,500.00	Anuluar
4.	Servisimi dhe mirëmbajtja e veturave të Kuzhinës	5,500.00	Kontraktuar
5.	Marrja me qira e veturave	120,000.00	Në proces

Gjatë kësaj periudhë janë zhvilluar këto aktivitete. Në dy raste, procedurat fillestare janë anuluar pasi nuk kemi pranuar asnjë ofertë nga palët e interesuara. Pas kësaj, kemi rishpallur këto procedura brenda afateve ligjore, duke ndjekur të gjitha rregullat dhe udhëzimet përkatëse. Këto rishpallje kanë rezultuar me sukses dhe janë kontraktuar në përputhje me kërkesat tona.

Gjithashtu, jemi në proces të marrjes së ofertave për procedurën e marrjes me qira të veturave për 36 muaj, gjashtë (6) vetura. Afati për dorëzimin e ofertave për këtë procedurë është deri më datën 10 korrik. Pas përfundimit të këtij afati, do të shqyrtojmë të gjitha ofertat e pranuar

Krahasim me vitin 2023

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2023, Zyra e Prokurimit ka realizuar tetë (8) aktivitete të ndryshme prokurimi me një fokus të qartë në përmirësimin e kushteve të punës dhe rritjen e efikasitetit të Kuzhinës. Ndër projektet e realizuara përmendim mirëmbajtjen dhe servisimin e pajisjeve, renovimin e zyrave të takimit, furnizimin dhe montimin e rrjetave dekoruese, ndërtimin e recepcionit dhe qëndrimit për punëtorët, furnizimin dhe montimin me çilur modular për ftohje dhe ngrohje, si dhe disa aktivitete të tjera që lidhen me përmirësimin e hapësirave të punës.

Numri i aktiviteteve në tremujorin e dytë të vitit 2023 janë realizuar tetë (8) aktivitete prokurimi, ndërsa në të njëjtën periudhë të vitit 2024 janë realizuar pesë (5) aktivitete.

Aktivitetet e vitit 2023 përfshijnë investime për përmirësimin e Kuzhinës Qendrore, ndërsa aktivitetet e vitit 2024 përfshijnë një fokus më të madh në auditime dhe servise (mirëmbajtje).

Proceset e anulimit dhe ritenderimit në vitin 2024, dy procedura fillestare janë anuluar dhe rishpallur për shkak të mungesës së ofertave, gjë që nuk është evidentuar në vitin 2023.

Projekte të veçanta dhe në proces projekti më i rëndësishëm në vitin 2023 ishte furnizimi dhe montimi me Çiler modular për ftohje dhe ngrohje, ndërsa në vitin 2024, procedura më e rëndësishme është marrja me qira e veturave, e cila është ende në proces.

Departamentin e shërbimeve të përbashkëta

Departamenti i Shërbimeve të Përbashkëta në tre mujorin e dytë të vitit 2024 ka kryer këto angazhime:

Në bazë të rregulloreve të brendshme të ndërmarrjes si dhe në bazë të kontratës "Në Shtëpi" që ndërmarrja jonë N.P.L "Ku'zina" sh.a ka me Komunën e Prishtinës, gjatë kësaj periudhe, Departamenti i Shërbimeve të përbashkëta në bashkëpunim edhe me Departamentin e Financave ka përcjelle procesin e dërgimit të shujtave në Institucionet Parashkollë, gjithashtu kemi kryer regjistrimin e shujtave si dhe dërgimin e faturës së rregullt mujore në Komunën e Prishtinës. Duhet të theksojmë që gjatë kësaj periudhe kohore, ne kemi kryer specifikat edhe për aneks kontratën e re që përfshinë dërgimin e shujtave në Qendrën e të Moshuarve dhe tek Brigada e Zjarrfikëseve, si dhe kemi vazhduar të kryejmë procedurën e rregullt edhe për rastet sociale në dy qendrat sociale "Aktash" dhe "Tophane".

Gjatë kësaj periudhe kohore Departamenti i Shërbimeve të Përbashkëta është angazhuar që t'i plotësoj kërkesat për shpërndarjen e ushqimit. Këtu kemi vazhduar punën e rregullt të shpërndarjes së ushqimit tek kopshtet publike dhe ato në bazë në komunitet si dhe është ndihmuar edhe në aktivitete të tjera siç janë shërbimet catering apo edhe rastet e veçanta të shpërndarjes së ushqimit.

Në tre mujorin e dytë bashkë edhe me udhëheqësin e Departamentit Ligjor dhe të Administratës, kemi arritur që me organizatën humanitare Humanity First Kosova të kemi të nënshkruar një Memorandum Mirëkuptimi për shpërndarjen e ushqimit falas për qendrat sociale në "Aktash" dhe në "Tophane" ku përfitues të këtij memorandumi kanë qenë rreth 4 mijë persona në nevojë kurse shpërndarja e ushqimit është bërë në disa ditë të ndara.

Si çështje që duhet theksuar është edhe përfundimi me sukses i procedurës për servisimin e veturave aktuale të ndërmarrjes, ku pas përfundimit të procedurave të prokurimit nga zyra e prokurimit, kemi përfunduar edhe servisimin e veturave, si dhe kemi rregulluar elementet mekanike në veturat përkatëse ku ka pasur nevojë.

Gjatë kësaj periudhe kohore në ndërmarrjen tonë ka ndodhur një dëmtim i theksuar i pajisjeve tona teknike dhe të prodhimit. Një gjë e tillë ka ardhur si pasojë e dëmeve që ka shkaktuar një lidhje e gabuar nga rrjetit elektrik nga zyrtar të KEDS-it, pasi kanë instaluar rrjetin e ri, kur kanë kyçur sistemin elektrik kanë bërë lidhje nga trafo qendrore direkt në objektin e Kuzhinës ku fuqia e rrjetit elektrik ka qenë përtej përmasave përballues, çka ka shkaktuar dëme të konsiderueshme në pajisjet tona.

Ne si ndërmarrje, kemi njoftuar zyrtarët e KEDS-it për dëmet e shkaktuara, dhe kemi hapur rastin në Policinë e Republikës së Kosovës.

Zyra për Menaxhimin e Kontratave

Gjatë periudhës raportuese janë zhvilluar këto aktivitete:

Përgatitja e rregullt mujore e konstatimeve të furnizimit nga operatorët ekonomik nga menaxheret e kontratave për 10 njësit dhe plotësimi i rregullt mujor i specifikacionit të furnizimit të kalkuluar për çdo artikull ushqimor.

Vlerësimi i tenderit për furnizim me peme dhe perime- sipas vendimit të përcaktuar nga KE, ne muajin Prill (8 Prill 2024) është bërë vlerësimi i tenderit për furnizim me peme dhe perime dhe ne mesin e tre operatoreve komisioni vlerësues ka përzgjedh operatorin Dauti KOMERC i cili ka përmbush kërkesat e përshtatshmërisë së përcaktuara nga zyra e prokurimit. Kontrata sipas planit të menaxhimit të kontratës është planifikuar dhe nënshkruar për 6 muaj : 18 prill 2024 -18 tetor 2024 . Vlerësimi i ofertës për aktivitetin e prokurimit – Servisimi dhe mirëmbajtja e automjeteve të kuzhinës – sipas vendimit të përcaktuar nga KE, ne muajin Maj 2024 (21 Maj 2024), është bërë vlerësimi i tenderit . Kontrata është në vlerë të poentuar 12,959.00

euro , ndërsa vlera e parashikuar e sipas disponueshmeris se mjeteve nga Kuzhina është 5,500 euro për 24 muaj. Pas vlerësimit, OE ka nënshkruar kontratën dhe është bere përgatitja e planit për menaxhim te kontratës për 24 muaj nga 29.05.2024- 29.05.2026.

Kontratat aktive dhe lloji i prokurimit

N.P.L "KU.ZINA"sh.a aktualisht i ka 13 kontrata aktive , kontrata te planifikuara për zhvillimin e objektivave te ndërmarrjes për vitin 2024 e te iniciuara nga zyra e prokurimit. Sipas nevojave te Ndërmarrjes për furnizime dhe shërbime si dhe në mbarëvajtjen e punëve në ndërmarrje, për 13 kontrata aktive kemi 14 kategori te furnizimeve sipas kësaj përmbajtje:

Raport TM2 (Prill, Maj, Qershor) 2024		
Nr	Kategoritë e Furnizimit/shërbimit	Vlera e pagesës për periudhën TM2 (€)
1	Furnizim me Bukë dhe brumëra te tjera	22,838.02
2	Furnizim me mish gjedhi dhe produkte te mishit te gjedhit	15,930.00
3	Furnizim me mish pule dhe produkte te mishit te pulës	6,297.80
4	Furnizim me Peme dhe Perime	26,225.92
5	Furnizim me artikuj ushqimore	4,392.80
6	Sigurimi shëndetësor dhe aksidental për punëtorët e Kuzhinës Qendrore	4,786.40
7	Furnizim me karburante	2,038.02
8	Furnizim me paketime ushqimore	19,859.66
9	Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve te Kuzhinës	
10	Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve	1,272.00
11	Furnizim me ujë te pijes	184.00
12	Furnizim me qumësht dhe produkte te qumështit	10,227.57
	Total:	114,052.19

Krahasuar me periudhën raportuese të TM 2- 2023 shohim se kemi shtim të 3 kategorive të furnizimit (Produkte dhe shërbime).

Vlera financiare e furnizimeve për periudhën raportuese Tm2 2024 të produkteve me origjinë bimërore, shtazore dhe produkte tjera mbështetëse ishte 115,768.03 Euro, ndërsa krahasuar me periudhën raportuese Tm2 2024 sipas të dhënave financiare statistikore konstatohet se është 104,460.90 Euro.

Ndërsa sa i përket përqindjes së shfrytëzimit të kontratave aktive për periudhën raportuese TM2 2024 kemi këto rezultate :

Nr	Kategoritë e Furnizimit/shërbimit	% e pashfrytëzuar e kontratës	% e shfrytëzuar e kontratës
1	Furnizim me Bukë dhe brumëra të tjera	61.10%	39.00%
2	Furnizim me mish gjedhi dhe produkte të mishit të gjedhit	65.50%	34.50%
3	Furnizim me mish pule dhe produkte të mishit të pulës	53.10%	47.00%
4	Furnizim me Peme dhe Perime	68.00%	32.00%
5	Furnizim me artikuj ushqimorë	63.60%	36.44%
6	Sigurimi shëndetësor dhe aksidental për punëtorët e Kuzhinës Qendrore	92.00%	78.00%
7	Furnizim me karburante	65.00%	35.00%
8	Furnizim me paketime ushqimorë	73.00%	27.00%
9	Servisimi dhe mirëmbajtja e pajisjeve të Kuzhinës	54.00%	46.00%
10	Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve	77.00%	23.00%
11	Furnizim me ujë të pijes	91.00%	9.00%
12	Furnizim me qumësht dhe produkte të qumështit	69.00%	31.00%

Përgatitja e konceptit të dokumentit dhe aplikimi në Kiesa

Sipas shpalljes publike te Ministrisë se Tregtisë dhe Industrisë (Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë KIESA) për subvencionim të NVM-ve për blerjen e makinerive prodhuese /përpunuese, me 26 Prill 2024 kemi aplikuar ne këtë projekt për Pajisje profesionale industriale për paketim shujtave ditore te ndërmarrjes ne vlere prej 35 000 euro.

Sipas kritereve te përcaktuara nga Kiesa ne kodin 10 përpunimi i produkteve ushqimore Loti 3 (bashkëfinancim 50%) , kemi përgatit projekt propozimin , planin buxhetor ,planin e aktiviteteve te veprimit dhe dokumentet tjera administrative , te cilat janë ngarkuar përmes platformës E-Kosova.

Përgatitja e projektit për aplikim në Ministrin e zhvillimit rajonal (MZHR)

Sipas thirrjes se propozuar nga Ministria e zhvillimit rajonal -Skema e Granteve "Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar (PZHRB) 2024" me datën 05.06.2024 kemi aplikuar me projekt përmes platformës e- Kosova.

Ne kuadër te platformës janë ngarkuar dhe azhurnuar projekt propozimi ,plani i veprimit, projeksioni financiar si dhe oferta për makinerinë apo pajisjet/shërbimet e planifikuara në ne vlere prej 24,095.60 €. Shpërndarja e shujtave për sektorin privat dhe shërbimet CATERING

Në sektorin e administratës në 3 mujorin e dytë te viti 2024 , ne koordinim dhe bashkëpunim me departamentin e distribuimit kemi bere shpërndarjen e shujtave ne sektorin privat , si dhe jemi përkujdesur qe shërbimet e cateringut te shpërndahen dhe servohen sipas itinerareve te përcaktuara te klientëve tonë .

Ekipi i shitjes

.Sipas vendimit te KE për themelimin e ekipit te shitjes , ne 6 mujorin e parë te vitit 2024 sipas planin ideor te shitjes dhe me qellim te prezencës se ndërmarrjes ne treg përveç kontakteve dhe vizitave ne terren , jemi aktivizuar edhe ne një segment tjetër te prezantimit te produkteve qe ndërmarrjes .Ky segmentin i tregut përfshin prezantimin e shujtave pranë kopshteve private te komunës e Prishtinës dhe Fushe Kosovës .

Nga lista e siguruar- ËEb Ministria e Arsimit , i kemi identifikuar 84 kopshte private për grup moshat 9 muaj – 6 vjet ne Komunën e Prishtinës , ndërsa ne Fushe Kosove janë identifikuar 15 kopshte.

Bazuar ne këto informata ne kemi kontaktuar 90 % te kopshteve për te dy komunat dhe disa nga to kane pranuar qe ti vizitojmë dhe prezantojmë produktet qe ofron kuzhina qendrore , mirëpo deri me tani nuk kemi ndonjë kopsht te interesuar për furnizim .

Gjithashtu kemi bere 2 marrëveshje te furnizimit me shujta te rregullta ditore pre 2 kompani private: Elmond dekor dhe ECo CLimte.

Zyra për marrëdhënie me publikun

Që nga fillimi i vitit 2024 kemi nënshkruar një kontratë me një kompani për transmetimin e reklamave që kanë të bëjnë me promovimin e produkteve tona nëpër emisione që transmetojnë kryesisht mënyrën e përgatitjes së ushqimeve të ndryshme. Në këtë mënyre është rritur prezenca e jonë në media, në krahasim me periudhën e njëjta të vitit të kaluar.

Zyra për marrëdhënie me publikun përtej detyrave dhe përgjegjësiwe që ka, në baza të rregullta merret edhe me forma të tjera të komunikimit siç është ajo përmes rrjeteve sociale. Përmes ëeb-faqes, facebook dhe instagram ju kthejmë përgjigje te gjitha pyetjeve që vijnë nga mediat, organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarëve.

Gjatë këtyre tre muajve përveç që zbatoi detyrat brenda përgjegjësiwe dhe fushëveprimit që ka, ka publikuar revistën tashme mujore Ku'zina ne tre vëllime ku në përmbajtjen e saj përshihen aktivitetet e muajit në ndërmarrje, risit në menynë e kuzhinës, informata të ndryshme rreth shëndetit, këshilla si dhe çdo muaj prezantohen përvojat e ndryshme të punonjësve të kuzhinës.

Po ashtu jemi të angazhuar edhe në secilin aspekt tjetër të komunikimit me qëllim të vetëm që qytetarët, mediat dhe institucionet tjera të jenë të informuar në kohë për të gjitha zhvillimet dhe risit që ndodhin në Ku'zina.

Tremujori i tretë

Gusht - Tetor 2024

DEPARTAMENTI I FINANCAVE

Departamenti i financave në periudhën raportuese ka luajtur një rol të shumëfishtë në përfshin menaxhimin e aseteve financiare të ndërmarrjes, planifikimin financiar, dhe sigurimin e qëndrueshmërisë ekonomike. Roli i këtij departamenti mund të përmblihet në funksionet e mëposhtme kryesore siç është planifikimi financiar dhe buxheti, kontabiliteti dhe raportimi financiar si dhe kontrolli i kostove dhe efikasiteti operativ. Gjatë periudhës raportuese, departamenti ka luajtur një rol të rëndësishëm në sigurimin e qëndrueshmërisë financiare dhe rritjes së ndërmarrjes.

Të ardhurat dhe fitimet

Periudha e tretë e vitit 2024 ka arritur vlerën e shitjes në 289,879.06 euro. Rritja e të hyrave ka ndodhur më së shumti në muajin Shtator të këtij viti si rezultat i rritjes së numrit të vijueshmërisë së fëmijëve pranë Institucioneve Parashkollore Publike dhe Publiko-private dhe përfundimin e pushimeve verore të Institucioneve Parashkollore. Në këtë periudhë të vitit të kaluar (2023), të hyrat kanë qenë 256,037.73 euro.

Në TM3 të vitit 2024 kemi 33,841.33 euro më shumë të hyra krahasuar me vitin 2023.. Kurse të hyrat nga operatorët privat janë zvogëluar për 9,945.46 euro krahasuar me vitin paraprak. Totali i këtyre të hyrave është 17,817.24 euro. Në muajin Gusht kemi pasur rritje të kërkesë për shërbimin e cateringut dhe janë shtuar kontratat me operatore ekonomik privat. Kërkesa për shtije me të gatshme është mesatarisht 1,400 euro.

Shitje TM3	IP, QS, SHP,BZ	Op.Privat	Totali
Korrik	80,786.86	5,138.46	85,925.33
Gusht	84,463.72	7,719.96	92,759.95
Shtator	106,811.23	4,958.81	111,770.05
	272,061.82	17,817.24	289,879.06

Në tre mujorin e dytë të vitit 2024, Ndërmarrja ka ndarë buxhet prej 170,676.66euro për paga.

Krahasuar me vitin e kaluar për periudhën e njëjte kemi shtim të buxhetit prej 48,294.38 euro. Ky ndryshim ka ndodhur si rrjedhojë e ndryshimit të numrit të punëtorëve dhe rritjes së pagave krahasuar me vitin paraprak. Në muajin Shtator është rritur numri i të punësuarve, si dhe puna jashtë orarit me fillimin e procesit të mësimi tërë ditor në Shkolla Fillore.

Viti 2024	Paga Bruto
Muaji Korrik	52,586.66
Muaji Gusht	57,719.00
Muaji Shtator	60,371.00
Totali për tre muaj	170,676.66

Shpenzimet

Në tabelën me poshtë janë paraqitur llojet e shpenzimeve të ndodhura gjatë këtij tre mujori të tretë.

Në vitin 2023 vlera totale e shpenzimeve për këtë periudhë ka qenë 140,384.13euro Këtë vit kemi 76,190 me shume sepse kemi pasur investime dhe blerje të aseteve, për përgatitjet e mësimi tërë ditor. Gjithashtu shohim që vlera e shitur është në proporcion të drejte me vlerën e blerjes së lëndës së pare. Në këtë periudhë janë shtuar shpenzimet fikse tashme që janë marrja me qira e veturave për nevojat e Kuzhinës.

Tabela e shpenzimeve

	Korrik	Gusht	Shtator	Totali
Totali i shpenzimeve	33,332.31	50,585.62	132,656.35	216,574.28
Lënda e parë	26,786.92	35,627.05	42,041.14	104,455.11
Shpenzime për naftë	817.42	718.76		1,536.18
Shpenzime për telefon	173.72	56.89	140.23	370.84
Shpenzime për trajnime-avancim		1,500.00		1,500.00
Shpenzime të reprezentacionit	218.69	414.35	170.59	803.63
Shpenzime tjera (ushqimit)			116.19	
Shpenzime të interneti	50.85	50.85	50.85	152.55

Shpenzime të rrymës	1,678.5	1,744.70	1715.58	5,138.78
Shpenzime për material shpenzues	89.38	111.00	13.1	213.48
Shpenzimet për zyre	114.4	269.48	459.03	842.91
Shpenzimet e reklamës dhe revistave			251.69	251.69
Shpenzimet e higjienës	300.86	1,804.66	69.49	2,175.01
Shpenzimet e mirëmbajtjes së objektit (NPB)		5,400.00		5,400.00
Shpenzimet e mirëmbajtjes se uebfaqes		266.78		266.78
Shpenzimet e mirëmbajtjes se veturave, sigurimi dhe servisim	243.31	147.45	203.14	593.90
Shpenzimet e mirëmbajtjes se pajisjeve te kuzhinës	423.73		4,627.12	5,050.85
Shpenzimet e mirëmbajtjes se programit kontabilitetit	72.88			72.88
Shpenzimet e mirëmbajtjes se liftave		80.00		
Shpenzimet e paketimeve	398.26	635.85	935.9	1,970.01
Shpenzim Aset – Subvencion nga Komuna			74,894.92	74,894.92
Shpenzimet e GPS-ve së veturave	101.69	67.80	67.80	237.29
Shpenzimet e qirasë së veturave			5,074.58	5,074.58
IKSHPK	216		135	351.00
Shpenzimet e sigurimit shëndetësor	1645.7	1690	1690	5,025.70

Departamenti ligjor dhe administratës

Ky raport përmbledh aktivitetet e realizuara nga Departamenti Ligjor dhe Administrata i Ndërmarrjes gjatë tremujorit të tretë të vitit 2024. Veprimtaria e departamentit ka qenë në përputhje me kërkesat dhe nevojat e identifikuara, duke synuar një përmirësim të vazhdueshëm të akteve ligjore dhe nënligjore, me qëllim zbatimin e drejtë dhe efektiv të normave ligjore.

Më poshtë paraqiten detajet e punëve të kryera gjatë kësaj periudhe.

I. Aktivitetet e realizuara

1. Përpilimi i kontratave të punës pas përfundimit të konkursit të dt. 17.05.2024
2. Menaxhimi i kontratës për sigurimin shëndetësor të punonjësve.
3. Hartimi i kontratave për ofrimin e shujtave ushqimore me operatorët privat ekonomik.
4. Realizimi i punëve të lidhura me përmirësimin e infrastrukturës së objektit të ndërmarrjes.

II. Vendime dhe akte të lëshuara

- Për kompensimin e ditëve të pa shfrytëzuara të pushimit vjetor.
- Mbështetje financiare për përfundimin e shkollimit të punonjësit Behxhet Shala.
- Për përgjegjësinë disiplinore dhe materiale

1. Njoftime dhe shkresa të tjera

- Lëshimi i dokumenteve si vërtetime dhe njoftimeve për organizimin dhe mbarëvajtjen optimale të punës në ndërmarrje.

Departamenti shitje dhe marketing

Gjatë kësaj periudhe të raportimit, departamenti i ka kryer të gjithë detyrat dhe përgjegjësit për të cilat është i thirrur.

Është bërë përgatitja e rregullt mujore e specifikacioneve të shujtave të cilat dërgohen në baza të përditshme në Institucionet Parashkollore (IP), Qendrat Sociale (Aktash dhe Tophane), BPZ Zjarrfikësit, Qendrën Sociale për të moshuar dhe Shkollat Filllore.

Është bërë përgatitja mujore e specifikacionit dhe konstatimit për përgatitjen e faturës që i dërgohet Komunës, sipas Kontratës në shtëpi, të nënshkruar me Komunën e Prishtinës.



Më poshtë, mund të gjeni edhe tabelat e shpërndarjes së shujtave për tre mujorin e tretë të vitit 2024.

	Korrik	Gusht	Shtator
Institucionet Parashkollore Publike	14,868	13,168	27,925
Institucionet Parashkollore me bazë në komunitet	14,251	17,998	18,246
Qendrat Sociale	6,900	6,600	6,300
Qendra Sociale për të moshuar	5,794	5,550	5,187
BPZ Prishtinë (zjarrfikësit)	1,901	1,884	1,809
Shkollat Filllore	n/a	n/a	23,100
Shërbimet Catering	6 organizime 300 persona	6 organizime 648 persona	7 organizime 574 persona
Porosit private	7-biznese, 3,104 porosi	7-biznese, 3,723 porosi	7-biznese, 2,737 porosi

Në tremujorin e tretë të vitit 2024, më saktësisht nga fillimi i muajit Shtator, Ku` zina ka filluar edhe shpërndarjen e shujtave ushqimore në dy (2) shkolla filllore, më saktësisht në Shkollën e Gjelbër” dhe Shkollën Filllore “Qamil Batalli (Shkolla Model).


Po ashtu, ndërmarrja ka vazhduar shpërndarjen e shujtave ushqimore

për Institucionet Publike, Qendrat Sociale Aktash dhe Tophane, Qendrat Sociale për të moshuar dhe BPZ Zjarrfikësit.



Gjatë periudhës së raportimit, ndërmarrja ka shënuar rritje pozitive (krahasuar me periudhën e tre mujorit të dytë të vitit 2024) tek sektori privat. Me mbylljen e tre mujorit të tretë, ndërmarrja ka

shpërndarë 3,866 porosi më shumë se në periudhën e TM2. Krahësuar me këtë periudhë, kemi shënuar rritje edhe me shërbimet Catering, ku si përfundim i këtij tre mujori kemi arritur të shpërndajmë ushqim për 19 organizime të ndryshme, përfshirë 1,522 persona. Vlen të theksohet që gjatë kësaj periudhe, kemi arritur marrëveshje me AZTECH Sh.p.k. ku në baza ditore shpërndahen 40-50 shujta ushqimore.



Krahësuar me periudhën e njëjtë (TM3) të vitit të kaluar, ndërmarrja ka shënuar rënie tek shitjet private në baza ditore. Por, rritje të theksuar ndërmarrja ka shënuar tek shërbimet Catering, ku në periudhën e njëjte vitin e kaluar janë organizuar 4 koktejt rasti, për 327 persona, kurse në vitin 2024 janë organizuar 19 koktejt rasti për 1,522 persona. Andaj, nëse krahasojmë totalin e të ardhurave, si nga shitjet private në baza ditore dhe shërbimet Catering të TM3, Departamenti ka shënuar rritje të lehtë krahasuar me TM3 të vitit 2023.



Departamenti i shërbimeve të përbashkëta

Në bazë të rregulloreve të brendshme të ndërmarrjes si dhe në bazë të kontratës "Në Shtëpi" që ndërmarrja jonë N.P.L "Ku'zina" sh.a ka me Komunën e Prishtinës, gjatë kësaj periudhe, Departamenti i Shërbimeve të përbashkëta në bashkëpunim edhe me Departamentin e Financave ka përcjelle procesin e dërgimit të shujtave në Institucionet Parashkollore, gjithashtu kemi kryer regjistrimin e shujtave si dhe dërgimin e faturës së rregullt mujore në Komunën e Prishtinës. Duhet të theksojmë që gjatë kësaj periudhe kohore, ne kemi kryer specifikat edhe për aneks kontratën e re që përfshinë dërgimin e shujtave në Qendrën e të Moshuarve dhe tek Brigada e Zjarrfikëseve, si dhe kemi vazhduar të kryejmë procedurën e rregullt edhe për rastet sociale në dy qendrat sociale "Aktash" dhe "Tophane".

Gjatë kësaj periudhe kohore, ndërmarrja jonë siç e dimë ka filluar të përgatis ushqimin edhe për shkollat fillore të cilat kanë filluar mësimin tërë ditë, dhe këtu përfshihen pesë shkolla. Për të gjitha këto shkolla, Departamenti i Shërbimeve të Përbashkëta me stafin e shpërndarësve të ushqimit ka mundur shpërndarjen e ushqimit në shkollat përkatëse, ku stafi shpërndarës kanë vazhduar të qëndrojnë në shkolla për t'i ndihmuar pjesës tjetër të stafit të ndërmarrjes tonë, deri në përfundim të procesit të ushqimit.

Gjatë kësaj periudhe kohore ne kemi angazhuar edhe vetura shtesë të cilat i kemi marrë në formë qiraje, qira e cila ka hyrë në funksion në përputhje me procedurat normative. Gjithsej janë marrë gjashtë (6) vetura të tipit Pick-Up dhe të njëjtit kanë hyrë në funksion për dërgimin e ushqimit në shkollat me mësim tërë ditë.

Në tremujorin e tretë ne kemi vazhduar me mirëmbajtjen e hapësirave të jashtme të ndërmarrjes tonë, ku ka vazhduar bashkëpunimi me ndërmarrjen "Gjelbërt" e cila ka qenë korrekte në bashkëpunim varësisht në kohën kur e kemi angazhuar. Po ashtu sa i takon hapësirave të jashtme, ndërmarrja ka përfunduar punën në ndërtimin e hapësirës për depo, ku fal angazhimit maksimal të Kryeshefit Ekzekutiv në bashkëpunim edhe me zyrtarët e depot, kemi arritur që tani të kemi një depo të përshtatshme për nevojat e kuzhinës, e cila është në funksion të plotë.

Sa i takon sektorit të sigurimit gjatë kësaj periudhe, sigurimi i objektit ka vazhduar të jetë stabil dhe i plotë, të njëjtit vazhdojnë të punonjë me orar të përcaktuar, dhe komfor angazhimit të tyre në si departament në baza të rregullta angazhohemi që ky sektor të mund të kryej në mënyrën më të mirë punën e tyre.

Zyra për Menaxhimin e Kontratave

Ky raport pasqyron punën në zyrën për menaxhim të kontratave dhe ecuritë e procedurave përgjatë muajve Korrik-Shtator, të vitit fiskal 2024.

Raporti paraqet një përmbledhje menaxhimit të kontratave duke theksuar aktivitetet kryesore dhe sfidat e hasura:

- Hartimi i kontratave duke definuar qartë kushtet e furnizimit, standardet e cilësisë dhe afatet e dorëzimit.
- Ndjekja e zbatimit të kontratave për të siguruar përputhshmëri dhe për të identifikuar çdo devijim.
- Monitorimi i furnizimit me aftë të caktuar, porosia dhe përgatitja e specifikacioneve të faturave nga OP.

Gjatë kësaj periudhe TM3 në zyrën për menaxhim të kontratave janë zhvilluar këto aktivitete:

1.1 Sipas vendimit të përcaktuar nga ZKA është bërë plotësim ndryshimi i vendimeve për menaxher të kontratës bazuar në kontrata aktive për këto kategori furnizuese:

- Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor Loti 3 dhe Loti5
- Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor Loti 4
- Furnizim me ujë të pijes.

1.2. Përgatitja e rregullt mujore e konstatimeve nga operatorët ekonomik aktiv të ndërmarrjes prej menaxhereve të kontratave për 19 njësit të furnizimit/shërbimit dhe plotësimi i rregullt mujor i specifikacionit të furnizimit të kalkuluar për çdo artikull ushqimor.

1.3 Planifikimi i furnizimeve

Sipas njoftimit zyrtar nga Agjencia Qendrore e Prokurimit për mbledhjen e të dhënave për aktivitetin e prokurimit gjatë kësaj periudhe sipas të dhënave të menaxhereve paraprakë dhe në bashkëpunim me njësinë kërkuese të KQ, i kemi plotësuar tabelat për

te dhënat lidhur me kërkesat vjetore te ndërmarrjes për artikujt ushqimor te secilit Lot.

Mbledhja e sasive dhe vlerat e planifikuara te kontratave nga njësit kërkuese është siç vijon:

NR	Emërtimi kontratave te planifikuara për AQP-n (Shtator 2024 - Shtator 2025)	Vlera financiare e parashikuar
1	Furnizim me mish gjedhi dhe produkte të mishit të gjedhit- Loti1	€ 152,887.00
2	Furnizim me mish pule dhe produkte të mishit të pulës. Loti 2	€ 59,771.60
3	Furnizim me qumësht dhe produkte të qumështit - Loti 3	€ 244,430.00
4	Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor - Loti 4	€ 218,325.60
5	Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor - Loti 5	€ 132,030.00
6	Furnizim me bukë dhe brumëra të tjerë	€ 255,412.80
	Total vlera financiare:	€ 1,062,857.00

Krahasuar me periudhën planifikuese te furnizimit 2023-2024, planifikimet për periudhën 2024 -2025 janë dyfishuar për shkak te rritjes se numrit te fëmijëve (plus 3000 fëmije) ne 5 shkolla fillore te Komunës se Prishtinës .

1.5 Kontratat aktive dhe menaxhimi

Në këtë periudhë raportuese ka 18 kontrata aktive me OE të planifikuara për zhvillimin e objektivave te ndërmarrjes për vitin 2024 e te iniciuara nga zyra e prokurimit.

Sipas nevojave te Ndërmarrjes për furnizime dhe shërbime si dhe në mbarëvajtjen e punëve në ndërmarrje, për 19 kontrata aktive kemi 10 kategori te furnizimeve ushqimore , 5 Kategori te furnizimeve tjera plotësuese dhe 4 shërbime sipas kësaj përmbajtje :

Raport TM3 (Korrik, Gusht, Shtator) 2024		
Nr	Kategorit e Furnizimit/shërbimit	Vlera e pageses per periudhën TM3
1	Furnizim me artikuj te ndryshem ushqimor - POLENTA	€ 4,382.20
2	Furnizim me material Higjientik	€ 2,373.50
3	Furnizim me paketime ushqimore	€ 2,324.65
4	Furnizimi me Vetura PICK -UP (36 muaj)	€ 5,988.00
5	Furnizim me Peme dhe Perime (6 Muaj)	€ 35,452.90
6	Furnizim me Paisje - garancion paisjet 2 vjet	€ 97,120.00
7	Mirembajtja dhe servisini I automjeteve KQ	€ 370.00
8	Mirembajtja dhe servisini I Pajisjeve KQ	€ 5,460.00
9	Hostimi dhe mirembajtja e WEB Faqes te KQ	€ 314.80
10	Sigurimi shendetsor dhe aksidental per punëtorët e Kuzhines Qendrore KQ	€ 4,662.40
11	Furnizim me mish gjedhi dhe produkte të mishit të gjedhit- Loti 1	€ 21,112.00
12	Furnizim me mish pule dhe produkte të mishit të pulës. Loti 2	€ 8,151.40
13	Furnizim me qumësht dhe produkte të qumështit -Loti 3	€ 9,425.00
14	Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor - Loti 4	€ 7,298.63
15	Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor - Loti 5	€ 11,741.64
16	Furnizim me bukë dhe brumëra të tjerë	€ 21,881.34
17	Furnizim me karburant ne rajonin e Prishtines Loti 5	€ 1,727.68
18	Furnizimi me uje te pijes	€ 327.68
19	Furnizim me Buke sandwiqi dhe buke hamburgeri	€ 992.50
	Total:	€ 241,106.31

Vlera financiare e furnizimeve për periudhën raportuese Tm3 2024 të produkteve me origjine bimore, shtazore dhe produkte tjera mbështetëse është 241,106.31 Euro.

Ndërsa sa i përket përqindjes se shfrytëzimit te kontratave aktive për periudhën raportuese TM3 2024 kemi këto rezultate:

Nr	Kategorit e Furnizimit/shërbimit	% e shfrytëzuar e kontratës
1	Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor - POLENTA	40%
2	Furnizim me material Higjientik	73%
3	Furnizim me paketime ushqimore	52%
4	Furnizimi me Vetura PICK -UP (36 muaj)	3%
5	Furnizim me Peme dhe Perime (6 Muaj)	76%
6	Furnizim me Paisje - garancion paisjet 2 vjet	50%
7	Mirembajtja dhe servisi i automjeteve KQ	30%
8	Mirembajtja dhe servisi i Pajisjeve KQ	100%
9	Hostimi dhe mirembajtja e WEB Faqes te KQ	75%
10	Sigurimi shëndetsor dhe aksidental per punëtorët e Kuzhines Qendrore KQ	31%
11	Furnizim me mish gjedhi dhe produkte të mishit të gjedhit- Loti 1	57%
12	Furnizim me mish pule dhe produkte të mishit të pulës. Loti 2	80%
13	Furnizim me qumësht dhe produkte të qumështit -Loti 3	43%
14	Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor - Loti 4	49%
15	Furnizim me artikuj të ndryshëm ushqimor - Loti 5	65%
16	Furnizim me bukë dhe brumëra të tjerë	55%
17	Furnizim me karburant ne rajonin e Prishtines Loti 5	70%
18	Furnizimi me uje te pijes	40%
19	Furnizim me Buke sandwiqi dhe buke hamburgeri	100%

Zyra Prokurimit

Gjatë këtij tremujori, Zyra e Prokurimit ka realizuar gjithsej **6 procedura** për furnizim të mallrave dhe shërbimeve të ndryshme. Procedurat përfshijnë furnizimin e artikujve ushqimor, pajisjeve për shkolla dhe shërbimeve tjera të nevojshme. Më poshtë, përshkruhen detajet e procedurave dhe fazat aktuale të disa prej tyre.

Tab. 1.

Kodi i procedurës	Përshkrimi	Lloji i procedurës	Vlera (EUR)
KQ-24-9374-1-2-1	Furnizim me artikuj ushqimor	Procedurë e hapur; Vlerë e mesme	52,000.00
KQ-24-9310-1-2-1	Furnizim me material higjenik	Procedurë e hapur; Vlerë e mesme	9,690.20
KQ-24-8373-1-4-7	Furnizim me bukë sanduiçi dhe hamburgeri	Procedurë e Vlerës Minimale	825.00
KQ-24-7916-1-1-5	Furnizim me vetura pikap për kuzhinën	Procedurë e negociuar pa publikim të	215,568.00

	qendrore - marrje me qira	njoftimit të kontratës; Vlerë e madhe	
KQ-24-7343-1-1-5	Furnizim me pajisje për Kuzhinën Qendrore	Procedurë e negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës; Vlerë e madhe	176,758.00
KQ-24-7263-1-3-6	Furnizim me pajisje të vogla për Kuzhinë	Procedurë e kuotimit të çmimit; Vlerë e ulët	2,000.00

Procedurat e Negociuara

Zyra e Prokurimit ka zhvilluar dy procedura të negociuara të rëndësishme për projektin e ri për shkolla, duke përfshirë furnizimin me pajisje dhe furnizim me vetura (marrje me qira) për nevoja specifike.

Furnizimi me vetura pikap për kuzhinën qendrore: Procedurë e negociuar me vlerë prej 215,568.00 EUR për marrje me qira të 6 veturave për 36 muaj për projektin e ri furnizim me ushqim në 5 shkolla.

Furnizimi me pajisje për Kuzhinën Qendrore dhe mini kuzhinat në 5 shkolla: Pajisjet përfshijnë gjithashtu mini kuzhina për 5 shkolla, që janë thelbësore për shërbimin dhe pastrimin e enëve. Kjo procedurë ka një vlerë prej 176,758.00EUR.

Procedurat e Hapura

Furnizimi me artikuj ushqimor: Në fazën e pritjes së afateve për ankesa, me vlerë të parashikuar prej 52,000 EUR.

Furnizimi me material higjienik: Procedura është përmbyllur me nënshkrimin e kontratës për 9,690.20 EUR, për 12 muaj.

Procedura e Kuotimit të Çmimit

Procedura për furnizimin e pajisjeve të vogla për Kuzhinë është anuluar për shkak të mungesës së ofertave të përgjegjshme.

Zyra e Prokurimit ka përmbyllur me sukses detyrat e saj për tremujorin Korrik-Shtator 2024, duke realizuar procedurat e nevojshme dhe duke përballuar sfidat e lidhura me zhvillimin e shpejtë të projekteve të reja për shkolla. Procedurat e negociuara për pajisje dhe marrje me qira ishin të domosdoshme për fillimin në kohë të projekteve kritike, ndërsa pjesa tjetër e procedurave janë në proces ose kanë përfunduar me sukses.

Departamenti i prodhimit

Departamenti i Prodhimit, përfshin në vete pjesën e përgatitjes së ushqimit. Gjatë kësaj periudhe kohore janë bërë zhvillime pozitive në këtë departament.

Në sektorin e Institucioneve Parashkollore të cilin e kemi përgatitur “Doracak për shërbimin dhe sigurinë e ushqimit” ky doracak është aplikuar nga stafi ku janë të përfshira:

Higjiena personale dhe kujdesi,

Rregullat e veshjes në punë

Rregullat higjienike dhe të mirësjelljes gjatë servimit të ushqimit

Fasiliteti sanitare

Ushqyerja e fëmijëve

Menaxhimi i papastërtive (mbetjeve)

Ky doracak është punuar bazuar në **LIGJIN 037-L016** për ushqimin dhe aktet e brendshme të ndërmarrjes.

Po ashtu në Departamentin e Prodhimit janë vendosur rregullat për mirëmbajtjen dhe sigurinë ushqimit nëpërmjet kontrollimit të temperaturave të magazinave dhe frigoriferëve, .

Për sigurinë, kujdesin e përgatitjes së ushqimeve merren mostrat nga çdo lloje i përgatitjes së ushqimit. Nga këto mostra departamenti mundë të ketë :

Analiza mikrobiologjike

Analiza fizike-kimike

Këto analiza kryhen në institutin kombëtar të shëndetësisë publike si dhe në laboratorët të cilët janë të certifikuar. Gjatë periudhës tre mujore janë marrë strisho të ndryshme në kuzhinë si dhe në produktet të ndryshme dhe analizën e ujit, gjë që rezultatet kanë qenë të kënaqshme nuk janë gjetur asnjë nga këta parametra si: Salmonella, Staphylococcus aureus, Escherichia coli, Bakteret koliforme, Numri i përgjithshëm i baktereve të gjalla mezofile që do të thotë se “Departamenti i prodhimit” ka pasur arritje të lartë në cilësinë e higjienës.

Sektori qendrat sociale

Sektori i qendrave sociale pasi që ka një meny të begatshme, janë shpërndarë shujta të nxehta dhe me vlere ushqyese, është pasuruar me pemë, djathë, sallat .

Sektori privat

Sektori privatë gjatë kësaj periudhe ka pasur një zhvillim të shkëlqyer në cilësinë si dhe është pasuruar menyja me produkte të reja lloje te ndryshme të gjellëve *si: sallata verore, kemi shtuar edhe llojet të ndryshme të ëmbëlsirave si: bombica, ravani me sherbet, rrollada, gurabija, pitë me molla*. Ndër produktet më të kërkuara kanë qenë: gullashi, fasuli, patate në furrë, file pule, hamburgeri, specia të mbushur.

Sektori privat ka zhvilluar po ashtu “finger food” ku kemi pasur organizime te ndryshme kokteje rasti .

Sektori privat gjatë kësaj periudhe kohore tre mujore ka arritur numri i porosive 11,541

Përgatitja e shujtave Korrik – Shtator

Numri i shujtave				
Sektori	Korrik	Gusht	Shtator	Totali 3 Mujor
Institucionet Parashkollore	28,148	31,047	44,887	104,082
Qendrat Sociale	6,300	6,000	6,300	18,600
Privat	2,976	4,342	4,223	11,541

Gjatë këtij tre muajve përveç që kemi zbatuar detyrat brenda përgjegjësisë dhe fushë veprimtarisë që ka si zyre, ne po ashtu kemi publikuar revistën tashme mujore Ku’zina në tre vëllime ku në përmbajtjen e saj përshihen aktivitetet e muajit në ndërmarrje, risit në menynë e kuzhinës, informata të ndryshme rreth shëndetit, këshilla të

ndryshme rreth kuzhinës etj. Po ashtu jemi të angazhuar edhe në secilin aspekt tjetër të komunikimit me qëllim të vetëm që qytetarët, mediat dhe institucionet tjera të jenë të informuar në kohë për të gjitha zhvillimet dhe risit që ndodhin në Ku'zina.

Tremujori i katërt

(Tetor – Dhjetor 2024)

Departamenti Ligjor dhe i Administratës

Ky raport përmbledh aktivitetet e realizuara nga Departamenti Ligjor dhe Administrata i Ndërmarrjes gjatë tremujorit të katërt të vitit 2024. Veprimtaria e departamentit ka qenë në përputhje me kërkesat dhe nevojat e identifikuara, duke synuar një përmirësim të vazhdueshëm të akteve ligjore dhe nënligjore, me qëllim zbatimin e drejtë dhe efektiv të normave ligjore.

Më poshtë paraqiten detajet e punëve të kryera gjatë kësaj periudhe.

II. Aktivitetet e Realizuara

5. Hartimi i Rregullore për plotësim ndryshimin e Rregullores për sistematizim të punëve dhe detyrave.
6. Shpallja e konkursit për pozitën Kryeshef Ekzekutiv më datë 27.11.2024.
7. Hartimi i termave të referencës dhe inicimi i procedurës tenderuese për Strategjinë Zhvillimore të Ndërmarrjes.
8. Menaxhimi i kontratës për sigurimin shëndetësor të punonjësve.
9. Hartimi i kontratave për ofrimin e shujtave ushqimore.
10. Realizimi i punëve të lidhura me përmirësimin e infrastrukturës së objektit të ndërmarrjes.

II. Vendime dhe Akte të Lëshuara

2. Vendime

- Organizimi i shpërndarjes së ushqimit në shkollat e mësimi tërë ditor.

- Mbështetje financiare për përfundimin e shkollimit të punonjësit Behxhet Shala.
- Sistemimi i punonjësve sipas rregullores së re për sistematizim të punëve dhe detyrave.

3. Opinione ligjore

- Opinioni ligjor mbi kompensimin e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve.

4. Njoftime dhe shkresa të tjera

- Lëshimi i dokumenteve si vërtetime dhe njoftimeve për organizimin dhe mbarëvajtjen optimale të punës në ndërmarrje.

III. Zyra për marrëdhënie me publikun

Zyra për marrëdhënie me publikun përtej detyrave dhe përgjegjësi që ka, në baza të rregullta, merret edhe me forma të tjera të komunikimit siç është ajo përmes rrjeteve sociale. Në këtë tre mujor janë shtuar postimet në ueb-faqes, facebook dhe instagram duke e informuar publikun për zhvillimet e shumta në ndërmarrje siç ka qenë mësimi tërë ditë duke paraqitur suksesin e ndërmarrjes në këtë proces sfidues, prezantimi i punës po ashtu kemi qenë në komunikim të vazhdueshëm me ta duke ju përgjigjur të gjitha pyetjeve që vijnë nga mediat, organizatat e shoqërisë civile dhe qytetarëve për të gjitha këto zhvillime. Gjithashtu kemi publikuar revistën tashme mujore Ku'zina në tre

vëllime ku në përmbajtjen e saj përshihen aktivitetet e muajit në ndërmarrje, risit në menynë e kuzhinës, informata të ndryshme rreth shëndetit, këshilla të ndryshme rreth kuzhinës etj.

Departamenti Ligjor dhe Administrata mbetet i angazhuar në përmbushjen e objektivave strategjike dhe në adresimin e nevojave të ndërmarrjes, duke ofruar mbështetje të qëndrueshme në të gjitha aspektet ligjore dhe administrative

Zyra Prokurimit

Zyra e Prokurimit gjatë këtij tremujori ka realizuar pesë procedura për furnizim të mallrave dhe shërbimeve të ndryshme. Katër procedura janë të nënshkruara dhe në realizim, ndërsa një procedurë është ende e

hapur për ofertim. Më poshtë, jepen përshkrime të hollësishme për secilën procedurë.

Tab. 1.

Kodi i procedurës	Përshkrimi	Lloji i procedurës	Vlera (EUR)
KQ-24-11343-1-3-6	Furnizim me paketim ushqimore	Procedurë e Kuotimit të Çmimit; Vlerë e ulët	8,109.80
KQ-24-11978-2-4-7	Pastrim gjeneral i Kuzhinës	Procedurë e Vlerës Minimale	517.50
KQ-24-12031-1-4-7	Furnizim me material për ujësjellës	Procedurë e Vlerës Minimale	950
KQ-24-12724-2-1-1	Hartimi i Strategjisë Zhvillimore dhe Planifikimi Strategjik për NPL Kuzhina sh.a	Procedurë e hapur	146,680
KQ-24-13633-2-2-1	Krijimi i identitetit (brendimi) dhe prezantimi medial për NPL Kuzhina	Procedurë e hapur; Vlerë e mesme	124,000.00

Procedurat e nënshkruara dhe në realizim

1. **Furnizimi me Paketim Ushqimor** Kjo procedurë ka për qëllim sigurimin e paketave ushqimore të nevojshme për funksionimin e rregullt të kuzhinës. Mallrat janë të dedikuara për plotësimin e nevojave të përditshme me standardet e kërkuara.
2. **Pastrimi Gjeneral i Kuzhinës** Procedura ka përfshirë organizimin e shërbimeve të specializuara për pastrim gjeneral të kuzhinës, duke siguruar kushte higjienike optimale dhe përmbushjen e standardeve të cilësisë.
3. **Furnizimi me Material për Ujësjellës** Në kuadër të kësaj procedure është siguruar furnizimi me materiale të nevojshme për mirëmbajtjen dhe funksionimin e sistemit të ujësjellësit në kuzhinë dhe hapësirat përcjellëse.
4. **Hartimi i Strategjisë Zhvillimore dhe Planifikimi Strategjik** Ky projekt strategjik është në proces të realizimit dhe ka për

qëllim hartimin e një plani të mirëfilltë zhvillimor dhe të një strategjie afatgjatë për ndërmarrjen publike. Dokumenti i planifikimit do të ndihmojë në vendimmarrje dhe në përcaktimin e prioritetëve për zhvillimin e mëtejshëm.

Procedura në Fushën e Ofertimit

5. **Krijimi i Identitetit (Brendimi) dhe Prezantimi Medial** kjo procedurë është në proces të ofertimit dhe ka për qëllim zhvillimin e një identiteti unik për ndërmarrjen, përfshirë krijimin e logove dhe materialeve të tjera vizuale.

Planifikimi i Prokurimit për Vitin 2025: Plani përfundimtar për vitin e ardhshëm është dërguar në Autoritetin Qendror të Prokurimit dhe përfshin një listë të detajuar të projekteve dhe furnizimeve të planifikuara për të mbështetur nevojat institucionale dhe qëllimet strategjike.

Raporti për Kontratat e Nënshkruara për Vitin 2024: Një raport gjithëpërfshirës është përgatitur, duke përfshirë të gjitha kontratat e nënshkruara gjatë vitit 2024. Ky raport është një pasqyrë e qartë dhe e plotë e procedurave të realizuara, duke garantuar transparencë dhe përputhje me rregullat e prokurimit.

Departamenti Shitje dhe Marketing

Gjatë kësaj periudhe të raportimit, departamenti i ka kryer të gjithë detyrat dhe përgjegjësit për të cilat është i thirrur.

Është bërë përgatitja e rregullt mujore e specifikacioneve të shujtave të cilat dërgohen në baza të përditshme në Institucionet Parashkollore (IP), Qendrat Sociale (Aktash dhe Tophane), BPZ Zjarrfikësit, Qendrën Sociale për të moshuar dhe Shkollat Filllore.


Është bërë përgatitja mujore e specifikacionit dhe konstatimit për përgatitjen e faturës që i dërgohet Komunës, sipas Kontratës në shtëpi, të nënshkruar me Komunën e Prishtinës.

Më poshtë, mund të gjeni edhe tabelat e shpërndarjes së shujtave për tre mujorin e katërt të vitit 2024.


	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Institucionet Parashkollore Publike	32,757	29,166	27,465
Institucionet Parashkollore me bazë në komunitet	20,268	17,860	18,359
Qendrat Sociale	6,800	6,000	6,600
Qendra Sociale për të moshuar	5,361	5,100	5,483
BPZ Prishtinë (zjarrfikësit)	1,873	1,776	1,796
Shkollat Filllore	59,747	61,887	53,146
Shërbimet Catering	9 organizime 630 persona	5 organizime 630 persona	11 organizime 645 persona
Porosit private	6-biznese, 1,649 porosi	6-biznese, 1,306 porosi	5 biznese, 1,694 porosi

Në tremujorin e katërt të vitit 2024, më saktësisht nga fillimi i muajit Tetor, Ku`zina ka filluar shpërndarjen e shujtave ushqimore edhe në tre shkolla të tjera fillore, më saktësisht në Shkollën Nazim Gafurri", Shkollën Fillore "Faik Konica" dhe Shkollën Fillore "Xhemajl Mustafa". Po ashtu, ndërmarrja ka vazhduar shpërndarjen e shujtave ushqimore për Institucionet Publike Parashkollore dhe në ato me bazë në Komunitet, Qendrat Sociale Aktash dhe Tophane, Qendrat Sociale për të moshuar dhe BPZ Zjarrfikësit.

Shpërndarja e shujtave nga Kuzhina për periudhën TM4 2024



Shitjet private



Krahasuar me periudhën e njëjtë (TM4) të vitit të kaluar, ndërmarrja ka shënuar rënie tek shitjet private në baza ditore. Por, rritje të theksuar ndërmarrja ka shënuar tek shërbimet Catering, ku gjatë kësaj periudhe janë organizuar 25 koktej rasti për 1,905 persona. Andaj, nëse krahasojmë totalin e të ardhurave, si nga shitjet private në baza ditore dhe shërbimet Catering, Departamenti ka shënuar rritje të lehtë krahasuar me TM4 të vitit 2023.

Departamenti i financave

Departamenti i financave në periudhën raportuese ka luajtur një rol të shumëfishtë në përfshin menaxhimin e aseteve financiare të ndërmarrjes, planifikimin financiar, dhe sigurimin e qëndrueshmërisë ekonomike. Roli i këtij departamenti mund të përmbliidhet në funksionet e mëposhtme kryesore siç është planifikimi financiar dhe buxhetimi, kontabiliteti dhe raportimi financiar si dhe kontrolli i kostove dhe efikasiteti operativ. Gjatë periudhës raportuese, departamenti ka luajtur një rol të rëndësishëm në sigurimin e qëndrueshmërisë financiare dhe rritjes së ndërmarrjes.

Të ardhurat dhe fitimet

Periudha e katërt e vitit 2024 ka arritur vlerën e shitjes në 312,886.75 euro. Rritja e të hyrave ka ndodhur më së shumti në muajin Tetor të këtij viti si fillimit të mësimin tërë ditore në shkolla fillore në Kryeqytet. Në këtë periudhe të vitit të kaluar (2023), të hyrat kanë qenë 312,886.75 euro.

Në TM4 të vitit 2024 kemi 362,745.8euro më shumë të hyra krahasuar me vitin 2023. Kurse të hyrat nga operatorët privat janë zvogëluar për 5,148.05euro krahasuar me vitin paraprak. Totali i këtyre të hyrave është 16,397.74 euro. Në muajin Dhjetor kemi pasur rritje të kërkesë për shërbimin e cateringut.

Shitje TM4	IP, QS, SHP,BZ, SHF	Op.Privat	Totali
Tetor	120,942.64	5,113.80	126,056.54
Nëntor	351,513.53	4,058.23	355,571.76
Dhjetor	186,778.84	7,225.71	194,004.25
Totali	659,235.01	16,397.74	675,632.55

Në tre mujorin e tretë të vitit 2024, Ndërmarrja ka ndarë buxhet prej 270,791.91 euro për paga.

Krahasuar me vitin e kaluar për periudhën e njëjte kemi shtim të buxhetit prej 99,711.22 euro. Ky ndryshim ka ndodhur si rrjedhojë e ndryshimit të numrit të punëtorëve dhe rritjes së pagave krahasuar me vitin paraprak. Në muaji Nëntor, Bordi i Drejtoreve ka ndarë vendim për ndarjen dhe shpërblimin e performancës për zyrtarët e lartë për vitin 2023. Kurse në muajin Dhjetor ndërmarrja ka ndarë pagën e trembëdhjete andaj edhe buxheti i pagave është dyfishuar.

Viti 2024	Paga Bruto
Muaji Tetor	61,460.00
Muaji Nëntor	90,437.43
Muaji Dhjetor	118,894.48
Totali për tre muaj	270,791.91

Shpenzimet

Në tabelën me poshtë janë paraqitur llojet e shpenzimeve të ndodhura gjatë këtij tre muajori të tretë.

Në vitin 2023 vlera totale e shpenzimeve për këtë periudhë ka qenë 140,384.13 euro. Këtë vit kemi 76,190 me shume sepse kemi pasur investime dhe blerje të aseteve, për përgatitjet e mësimit tërë ditor. Tabela e shpenzimeve

	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
Totali i shpenzimeve	70,644.12	140,623.33	79,329.54	290,596.99
Lënda e parë	58,178.04	47,487.56	59,736.35	165,401.95
Shpenzime për naftë	1,400.63	778.69	758.35	2,937.67
Shpenzime për telefon	38.33	184.97	5.08	228.38
Shpenzime për trajnime-avancim		4,440	63	4,503.00
Shpenzime të reprezentacionit	113.05	140.43	42.8	296.28
Shpenzime tjera (ushqimit)		100.85	200	300.85
Shpenzime të interneti	50.85	50.85	50.85	152.55
Shpenzime të rrymës	1,884.4	1,634.46	1,679.74	5,198.60

Shpenzime për material shpenzues	96.74	13.42	86.83	196.99
Shpenzimet për zyre	587.61	135.86	42.4	765.87
Shpenzimet e higjienës	338.55	221.18	377.55	937.28
Shpenzimet e darkës se fundvitit			2,254.24	2,254.24
Shpenzimet e mirëmbajtjes se klimave		163		163
Shpenzimet e mirëmbajtjes se veturave, sigurimi dhe servisim		1,771.18	306.82	2,078.00
Shpenzimet material për ujësjellës			805.08	805.08
Shpenzimet e mirëmbajtjes se objektit			1448.14	1448.14
Shpenzimet e paketimeve	855.34	912.5	1010.58	2,778.42
Shpenzim Aset – Subvencion nga Komuna		74,900		74,900
Shpenzimet për aktivizim te sistemit solare			1,700.00	1700.00
Shpenzimet e GPS-ve së veturave			101.69	101.69
Shpenzimet e transportit		321.3	749.70	1,071.00
Shpenzimet e udhëtimit zyrtar		522		522
Shpenzimet e qirasë së veturave	5,074.58	5,074.58	5,920.34	16,069.50
IKSHPK	336			336
Shpenzimet e sigurimit shëndetësor	1,690	1,690	1,690	5.070.00
Shpenzimet e reklamave		80.50	300	380.50

Departamenti i prodhimit dhe furnizimit

Departamenti i prodhimit dhe furnizimit përfshinë në vete pjesën e përgatitjes së ushqimit. Gjatë periudhës raportuese të TM4 2023 kanë qenë , "Institucionet Parashkollore", "Qendrat Sociale" si dhe "Sektori Privat", ndërsa në TM4 2024 janë shtuar përveç dy qendra të tjera si Qendra e të moshuarve si dhe Brigada e Zjarrfikëseve edhe pese (5) shkolla fillore të Kryeqytetit. Kjo ka pasur efekt pozitiv në departamentin e prodhimit.

Për shkollat fillore është bere meny me vlera të larta ushqyese.

Gjate kësaj periudhe kemi pasur edhe vizita nga fëmijët e Institucioneve Parashkollore, lidhur me procesin e përgatitjes se ushqimit të tyre.

Kemi evidentuar disa nga preferencat e klientëve, ku ndere me të pëlqyerat janë si: makarona kuzhine, qofte kuzhine, hamburger kuzhine, patate në furre kuzhinë etj.

Tek TM4 janë bërë kontrollet rutinë të ambientit dhe ushqimit ,janë marrë mostrat të cilat analizohen dhe komentohen rezultatet me rekomandimet e dhëna nga instituti të cilat zbatohen nga " Departamenti i Prodhimit".

Për sigurinë dhe kujdesin e përgatitjes së ushqimeve janë marrë mostra nga lloje te ndryshme te ushqimeve të përcaktuara sipas menysë , të kopshteve , shkollave , qendrave sociale , brigadës së zjarrfikëseve , shtëpia e të moshuarve, sektori privat.

Në këto mostra paraqiten:

Analizat mikrobiologjike dhe Analizat fizike-kimike

Në TM4 çdo gjë ka vijuar në mënyrë të rregullt dhe nën kontroll, po ashtu në këtë tre mujor është bërë analiza e ujit mikrobiologjike, fizike -kimike, e cila ka dal me rezultate të kënaqshme .Po ashtu janë marrë strisho të duarve nga i gjithë stafi, për shkak të kontrollit dhe sigurisë së ushqimit , si dhe janë vazhduar librezat sanitare tek personeli.

Fund!